

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7818 E martë 12 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Nga ARBEN IDRIZI



Dështimi tragjik i shtetit

Kosova është, ende, një vend pa një sistem social që do t'ia ofronte kujdesin e duhur asaj pjese të shoqërisë në nevojë ekzistenciale urgjente ose ...
Vijon në faqen 20

Opinion *i* Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



Boll i bëmë mirë qeverisë të na bëjë keq!

Po na ndodh si me atë hajdutin e fshatit që nuk kapej kurrë. Të gjithë e dinin që ai i vidhte pulat dhe madje edhe qengjat e njomë dhe që i shiste nuk merrej ...
Vijon në faqen 21



Deputetja e PD: Oksigjen për demokracinë

Rudina Hajdari nuk e dorëzon mandatin, Basha: Parlamenti, WC-ja e Edi Ramës

Vajza e "Heroit të Demokracisë": Babai im u përjashtua 2 herë nga PD. S'ri dot afër LSI

Rudina Hajdari do të vijojë të jetë deputete e Kuvendit të Shqipërisë, edhe me riskun për të mos qenë më pjesë e Partisë Demokratike që e nxori deputete. Hajdari bëhet zyrtarisht deputetja e dytë nga Partia Demokratike që refuzon dhënien e mandatit pas Myslim Murrizit. Hajdari u shpreh se, sipas saj, parlamenti i jep oksigjen demokracisë në vend, e për ...
Në faqen 2-4

TENSIONE TE "PETRO NINI", BANORET "BETEJE" ME PERMBARUESIT PRIVATE

PRONA NE TIRANE, BANORET PERPLASEN NE PERMBARIMIN

Familjet refuzojnë të dalin, "ngujohen" në shtëpira: Toka është e shtetit. Përmbaruesit godasin me shkelma dyert, Lleshaj: Lirohet kreu i policisë së Tiranës



(Në foto) Forca të policisë së rendit, duke u përpjekur të largojnë disa banorë nga shtëpitë e tyre, pranë shkollës "Petro Nini Luarasi".
Në faqen 9

VENDIMI

KQZ i jep mandatin 7 deputetëve të rinj, shkon në 14 numri i opozitarëve

Në faqen 3

UNIVERSITETI

Fushata e këshillimit të karrierës, "Luarasi" takim me maturantët në Lushnjë

Në faqen 10

SHENDETI

Lista, 300 personat që duhet të bëjnë kontrollin që të përfitojnë KEMP-in

Në faqen 11

KRYEQYTETI

Çelet ekspozita, ndryshimet e Tiranës në 30 vite në sytë e një italiani

Në faqen 18

LANDFILLI



Abuzimi me tarifën në Sharrë, flasin ndërtuesit: Ja si duhet ndryshuar

Në faqen 7

Lista e re/ 6 mijë familjet që iu njihet e drejta për të marrë paratë

Dosjet e '93-2013, pronarët që kompensohen

Emrat/ Agjencia e Trajtimit të Pronës: Si do ndahet fondi financiar

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të



gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të ...
Në faqen 12-13

KRIZA POLITIKE PROTESTA

Kreu i PD-së në Korçë: Heqim taksën e naftës, ulim çmimin e energjisë

Basha: Pakt Kombëtar, po afron fundi i qeverisë së hajdutëve

“Parlamenti sot është kthyer në WC të Ramës”

Valentina Madani

Nga Korça ku nisi turin e takimeve në prag të protestës së 16 marsit, kreu i opozitës Lulzim Basha foli dje për një pakt kombëtar, ku qeveria të ketë frikë qytetarët. Duke ftuar të gjithë të pranishmit t'i bashkohen protestës së opozitës në 16 mars, Basha tha se ata duhet të vendosin vetë për jetën e tyre. Korçarët i ftoi t'i bashkohen protestës së 16 Marsit, që e cilësoi jo betejë për pushtet, por për ndryshim. "Fundi i qeverisë së hajdutëve është i sigurt. Unë ju jap fjalën se kjo betejë nuk do të mbarojë vetëm me largimin e Ramës. Por me shembjen e kësaj qeverie që bën pakt me krimin dhe oligarkinë dhe pastaj i hip mbi shpinë qytetarëve. Unë ju ftaj që të bëheni pjesë e një konsultimi për një pakt kombëtar, në të cilin Shqipëria të ketë një qeveri që ka frikë qytetarët dhe jo qytetarë që kanë frikë qeverinë", theksoi z.Basha. Më tej ai u shpreh: "Parlamenti sot është paradhomë e kryeministrit. Mos të përdorndonjë shprehje tjetër, se mund të them që në këto momente, WC e kryeministrit". Me biznesin e vogël ndau programin ekonomik të PD-së, që sipas tij, synon uljen e taksave dhe mirëqenien për shqiptarët. Konkretisht lideri i opozitës premtoi heqjen e taksës mbi naftën si edhe uljen e çmimit të energjisë elektrike. "Ju të keni në dorë qeverisjen dhe qeveria të kujdeset për interesin e njerëzve. Kemi një qeveri që është shkëputur nga njerëzit. Nuk dëgjon njerëzit. Sa herë vij këtu, keq e më keq. Gjendja e biznesit ka ardhur duke u përkeqësuar. Do të heqim "Taksën Rama" mbi naftën me 300 lek që do të japë efekt të menjëhershëm tek biznesi dhe qytetarët. Çdo familje që ka një makinë dhe harxhon mesatarisht 100 litra naftë në muaj, kursen 30 mijë



Kreu i opozitës Lulzim Basha, dje në Korçë

FTESA

"Ju jap fjalën se kjo betejë nuk do të mbarojë vetëm me largimin e Ramës. Por me shembjen e kësaj qeverie që bën pakt me krimin dhe oligarkinë dhe pastaj i hip mbi shpinë qytetarëve. Unë ju ftaj që të bëheni pjesë e një konsultimi për një pakt kombëtar, në të cilin Shqipëria të ketë një qeveri që ka frikë qytetarët dhe jo qytetarë që kanë frikë qeverinë", theksoi z.Basha.

LSI, Gjoshja: Rama do ikë, zgjedhjet e parakohshme para qershorit

LSI ka bindjen e plotë se kryeministri Edi Rama do të dorëhiqet dhe se zgjedhjet e parakohshme do të jenë para atyre lokale. Sipas ish-deputetes së LSI-së Klajda Gjoshja, vendi do shkojë në zgjedhje të parakohshme para atyre të qershorit dhe se kryeministri Rama do të japë dorëheqjen. "Vendi është në situatë ekstreme. Cilido kryeministër përballë qytetarë e ka të vështirë të rezistojë. E them me bindje Rama do ta japë dorëheqjen", deklaroi znj.Gjoshja. Ish-deputetja e LSI-së, e ftuar dje në News 24 tregoi dhe arsyet që i shpallin të linin mandatet dhe tregoi se si do të vijojë aksioni opozitar. "Vota e opozitës nuk kishte më vlerë, të gjitha amendimet që ka dorëzuar opozita nuk janë marrë parasysh.



Kërkuam dialog për zgjedhjen e kryeprokurores dhe të gjitha na janë hedhur poshtë. Ligji për teatrin për Dividentin ishin arbitrare, por ne s'kishim Gjykatë Kushtetuese që të ankohehim, por si mund ta bëj detyrën unë si deputete në këto kushte? Rrugë radikale u ndërmor për të ndryshuar pushtetin e kalbur. Në lidhje me protestën e

ILIR META

Presidenti Ilir Meta vlerësoi dje me dekoratën e lartë "Nënë Tereza" presidenten e organizatës ndërkombëtare "People to People International", zj. Mary Jean Eisenhower, si dhe Konsullin e Përgjithshëm të Nderit të Shqipërisë në Atlanta të SHBA, ambasadorin Theodore Roosevelt Britton.

16 marsit, Gjoshja tha se ajo do të jetë më masivja, ndërsa do të ketë edhe përfaqësues nga diaspora. "Rama të dialogojë me ata që i ka në protesta. Më 16 mars do zhvillohet një nga protestat më të mëdha që ka parë Shqipëria në këto 20 vite. Do kemi edhe përfaqësues nga diaspora", u shpreh Gjoshja.

lekë. Për biznesin e vogël, për një kamioncinë, kursimi shkon në 90 mijë lekë në muaj, vetëm nga ulja e çmimit të naftës. Për biznesin e madh kursimi shkon deri në 700 mijë lekë të reja. Vetëm ulja e çmimit të naftës do të sjellë energji të reja në ekonomi. Do të ulë koston, do të rrisë fuqinë blerëse të

qytetarëve do të rrisë shiron dhe qarkullimin", theksoi kreu i PD-së. Përpara korçarëve të shumtë, z.Basha akuzoi kryeministrin Rama se qëndron pas ndërimit të TEC-it që e cilësoi një tjetër aferë korruptive që ka marrë miratimin e Ramës dhe ministrave të tij. "Ja ku është e vërteta. Edi Rama e ka

firmsur dhe bën gjoja sikur tërhiqet. Nxjerr këto qoftet e qeverisë. Jo Blend Klosin e kryetarin e Bashkisë. Të gjithë janë brenda, janë pjesë e kësaj afere. Helmi mbi Korçën pasuron Edi Ramën. Shikojeni firmën e Edi Ramës, Niko Peleshit, Sotiraj Filo. Kjo është qeveri kriminale. Se



Një nga protestat e opozitës

"Vetëm qenin e shtëpisë nuk e ka rrogëtar shteti"

Berisha nxjerr emrat: Të gjithë të afërmit që punësoi Ulsi Manja

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje denoncimin e qytetarit dixhital, i cili shkruan se kreu i Komisionit të Ligjeve në PS, Ulsi Manja, vetëm qenin e shtëpisë e ka pa rrogë shteti. Qytetari i ka kërkuar ish-kryeministrit që të publikojë të gjithë punësimet që ka bërë Manja në radhën e familjarëve dhe të afërmit pasi është bërë deputet. "Ulsi Manja veç qenin e shtëpisë e ka pa punë! Të punësuarit e Ulsi Manjës nga familja e tij, pasi është bërë deputet. Drejtori Shëndetit Publik Dibrë, Hasan Manja i vëllai. Në Drejtorinë e Shëndetit Publik Dibrë, Roza Manja nusja e Hasanit. Në OSHE Dibrë Fari Manja i vëllai. Drejtorja e Pyjorës Dibrë, Klodian Manja djali i vëllait. Spitali Peshkopi, Ornela Manja nusja e Klodianit. Drejtori i Trajtitimit të Studentëve tek Teknologjiku Shaziman Manja i vëllai. Nën-drejtoreshë shkollë në Laprakë, Marjeta Manja nusja e vëllait. Albgazi SHA Mira Manja e shoqja ekonomiste. Drejtor i Hetimit Tatimore të Republikës, Ardian Shehu dhëndri i vëllait. Kthimi dhe kompensimi i pronave emri Manja djali i vëllait. INUK-u Tiranë Florian Elezi djali i motrës. Aviacioni civil Qerim Manja djali i vëllait. Në Bashkinë Tiranë punësuar Pranvera Manja goca e vëllait të deputetit dhe nusja e Ardian Shehut drejtorit të hetimit tatimor Shtëpi tek Zogu i Zi dhe Shtëpi plazhi në Durrës. Makinë Forstradë e tipit ML Benz Mercedes e blerë 35.000 Euro. Aksioner në ndërtimin e një hidrocentrali në fshatin e Ulsit në Duhashisht të Dibrës, pikërisht në zonën e deputetit Ulsi Manja. Aksioner janë Bert Çupi nga Burrell, Paulin Rajta ish-drejtor i ALUIZNI-T dhe Flamur Ndreka që përdor lekët e Ulsit, është shofer i tij për të cilin po të verifikohet thuhet se dënuar dizin herë për grabitje e vjedhje në Itali", thuhet në mesazhin e qytetarit dixhital.



agogët e Universitetit të Korçës, Basha premtoi anulimin e ligjit për arsimin e lartë dhe stazhe për studentët sipas modelit gjerman. Lulzim Basha u kërkoi të rinjë që të mos largohen nga Shqipëria, por të qëndrojnë dhe të jenë ata që të marrin në dorë fatin e vendit.



**1 mijë votues
100-vjeçarë në
lista, Lleshaj: të
verifikohen në terren**

Në listat e zgjedhëseve ekzistojnë më shumë se 1 mijë zgjedhës me moshë mbi 100 vjeçare. Kjo ka bërë që të hidhen dyshime nëse listat janë të sakta apo jo, ndaj ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj i ka kërkuar prefektëve, drejtuesve të njësive vendore dhe atyre të zyrave të gjendjes civile të përbushin detyrimet sa i takon gjenierimit dhe afishimit të listave të zgjedhëseve, ku ndërmjet të tjerave të bëjnë edhe verifikimin e të gjithë votuesve 100-vjeçarë. "Duhet që të verifikojnë realisht në terren praninë e numrit të mbi 100-vjeçarëve, të cilat sipas të dhënave është një numër impresionues janë mbi 1 mijë veta, por duhen verifikuar realisht në terren se ku janë, kush janë, në mënyrë që të mos kemi dhe pasaktësi në këtë proces", - tha dje Lleshaj gjatë takimit me prefektët dhe drejtuesve të njësive vendore. Gjithashtu, Lleshaj vlerësoi edhe punën për regjistrin e ri të adresave. "Sot rezultojnë një gjendje krejtësisht e re ku pothuajse nga 300 mijë shqiptarë që në dhjetor 2018 nuk kishin një adresë të regjistruar, sot ky numër ka shkuar pothuajse drejt zeros", - shtoi ministri. Ai paralajmëroi edhe një iniciativë ligjore për të detyruar të gjithë ata njësitë dhe zyrat e gjendjes civile që të mos ofrojnë shërbimin nëse qytetari nuk ka një adresë të vlefshme sipas regjistrit.

**Seanca në 13 mars,
PS porosi deputetëve
për të injoruar
opozitën**

Kuvendi do ta zhvillojë seancën e tij të radhës ditën e mërkurë, më 13 mars. Shkak kësaj herë për ndryshimin e ditës së mbajtjes së seancës nuk është protesta e opozitës, por Dita e Verës. Duke qenë se dita e enjte bie 14 mars, pra është një ditë feste, mazhoranca ka vendosur që seancën ta mbajë një ditë më para. Pikërisht zhvillimet e pritshme të kësaj seance u diskutuan dje në mbledhjen e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ku deputetët kanë marrë disa porosi konkrete për mënyrën se si duhet të sillen në Kuvend tashmë që opozita reale nuk është më në sallë. Kështu, mësohet se deputetëve u është kërkuar që të kenë një prezencë të plotë, në mënyrë që të shmangen vështirësitë për shkak të kuorumit, si dhe për të treguar masivitet të deputetëve në sallë. Nga ana tjetër, ata janë porosit që të shmangin diskutimet apo komentet në sallë për opozitën e larguar dhe fjalimet dhe diskutimet e tyre t'i përqendrojnë vetëm te problemet dhe hallet qytetarë. "Të ketë prezencë në seancën plenare dhe disiplinë. Te mos ketë diskutime me objekt opozitën, por ligjet që do diskutohen në rend të ditës. Diskutimet të lidhen me nevojat e qytetarëve", - mësohet t'i jetë detyruar Ruçi deputetëve.

Me 5 mandatet e djeshme dhe 2 që do miratohen sot Kuvendi mbërrin në 93 deputetë

Marrin mandatin 7 kandidatë të tjerë, opozita e re me 14 deputetë

KQZ zëvendëson Lulzim Bashën me Ajlinda Halilaj

Opozita e re shkoi në 14 deputetë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dhënë dje mandatin e deputetit 5 kandidatëve të tjerë, ndërsa sot të njëjtin gjë pritet ta bëjë edhe për dy kandidatë të tjerë. Kështu, duke llogaritur 3 deputetët opozitarë që nuk e dorëzuan mandatin, 4 deputetët e rinj, që u betuan javën e shkuar dhe 5 kandidatët që morën mandatin dje dhe 2 të tjerët që e marrin sot rezultojnë se të mërkurën, kur edhe do mbahet seanca e radhës e Kuvendit të Shqipërisë ajo do jetë e përfaqësuar nga 14 deputetë, ndërsa Kuvendi arrin në 93, numër i domosdoshëm edhe për votime me shumicë të përfolur siç mund të jetë edhe ndryshimi i Kushtetutës.

ZËVENDËSIMET

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndryshe nga sa kishte paralajmëruar nuk ka plotësuar vendin e mbetur vakant nga dorëheqja e Gent Strazimirit, por atë të kryetarit të opozitës Lulzim Basha në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë. Në fakt, ka qenë nënkryetari i KQZ-së, Denar Biba ai që ka kundërshtuar projektvendimin e përgatitur nga administrata, duke kërkuar që zëvendësimin i deputetëve të bëhet sipas renditjes që gjenden në listat shumë emërore dhe jo sipas praktikës së ndjekur nga KQZ ku çdo deputeti që ka lënë mandatin i korrespondonte një kandidat konkret që gjendej në listë. Ky propozim është hedhur në votim dhe me 4 vota pro dhe 1 kundër ai është pranuar. Ndaj zëvendësimi i mandatëve për Qarkun Tiranë ka nisur pikërisht nga Lulzim Basha. Mandatin e tij e ka marrë Ajlinda Halilaj. Gjithashtu, KQZ miratoi mesditën e së hënës zëvendësimin e deputetit Astrit Veliajt me kandidatin e listës shumë emërore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, Lefter Maliqi. Maliqi nuk iu bashkua vendimit të partive opozitare për të mos e pranuar mandatin, ndërsa ka vendosur që të rikthehet në Kuvend si deputet për një mandat të dytë. Gjithashtu, KQZ plotësoi edhe vendin e lënë bosh nga Viktor Tushaj i LSI në Lezhë. Vendin e tij e zuri kandidatajta Elda Hoti. Sakaq, Nora Malaj, e zgjedhur deputete në Durrës nën siglën e LSI, e zëvendësoi Edlira Hys-



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

ZENELI

Zeneli kishte firmosur më parë deklaratën e mospranimit të mandatit, madje mori pjesë edhe në një nga protestat e opozitës përpara Kuvendit ku edhe foli përpara protestuesve. Nuk dihet se çfarë e ka shtyrë atë që të ndryshojë qëndrimin dhe të pranojë të marrë mandatin e deputetit.

Nuk dorëzuan dekriminalizimin, ja 14 emrat që nuk u kalon mandati

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të zhvillojë sot mbledhjen e radhës ku veç dënies së mandatit për dy deputetë të opozitës, pritet të marrë vendim për pazgjidhshmërinë e mandateve të tjera për 14 emrat e tjerë të listës së opozitës. Shkaku i mos plotësimit të vendeve të tjera të vakancës lidhet me faktin se kandidatët që duhet të caktohen si deputetë nuk kanë paraqitur deklaratën e dekriminalizimit, duke mos iu përgjigj afatit 10 ditor të KQZ-së. Në këto kushte, KQZ-ja nuk mund të japë mandate. Nisur nga kjo situatë, mësohet se në mbledhjen e nesërme do të kërkojë që të vijohet me listat pasuese, duke hapur edhe një herë procedurën për thirrjen e



atyre që janë në listën pasuese. Emrat që kanë refuzuar të marrin mandatin dhe për të cilët KQZ sot miraton pazgjidhshmërinë si deputet janë: Taulant Zeneli, Sindi Dau, Nada Krypa, Erisa

Xhixho, Elizabeta Kurti, Denisa Vata, Dritan Hylli, Mirela Dragoni Tabaku, Gerti Bogdani, Barbara Doda, Ina Haxhija, Sokol Dervishaj, Arben Ristani dhe Matilda Qurku.

eni dhe mandatin e Vangjel Tavos po nga LSI në Gjirokastrë, KQZ do ia dha Ediola Brahës. Ndërkohë që KQZ ka shtyrë vendimin për Ligoraq Karamelon. Sipas njoftimit të KQZ edhe ky rast do të trajtohet sot nga KQZ, ku, gjithashtu, pritet të bëjë edhe kalimin e mandatit të Flamur Nokës në Kukës për Alban Zenelin.

ZENELI

Kujtojmë këtu se Zeneli kishte firmosur më parë deklaratën e mospranimit të mandatit, madje mori pjesë

edhe në një nga protestat e opozitës përpara Kuvendit ku edhe foli përpara protestuesve. Nuk dihet se çfarë e ka shtyrë atë që të ndryshojë qëndrimin dhe të pranojë të marrë mandatin e deputetit. Zeneli ka qenë më parë deputetë i PD-së për Kukësin, ndërkohë që pak kohë më parë qeveria miratoi një ndihmë financiare për të përkurim jashtë shtetit. Gjatë mbledhjes së sotme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pritet të miratoi edhe 11 vendime të tjera për mosdhënien e man-

datit të 11 kandidatëve të tjerë. Bëhet fjalë për 11 kandidatë që nuk kanë paraqitur në KQZ formularin e dekriminalizimit dhe kanë firmosur deklaratën e mospranimit të mandatit. Mes kandidatëve që janë pjesë e vendimmarrjes së sotme janë edhe Arben Ristani dhe Sokol Dervishaj të dy kandidatë në Vlorë. Me miratimin e këtyre vendimeve, KQZ duhet të nisë nga e para procedurën për dërgimin e formularëve të vetëdeklarimit kandidatëve të tjerë të renditur në listë.

MANDATI QENDRIMI

Deputetja i kujton PD-së: Përrjashtuar 2 herë Azem Hajdarin dhe u pënduat

Rudina Hajdari s'e dorëzon mandatin: Vendimi i duhur

"Parlamenti i jep oksigjen demokracisë"

Rudina Hajdari do të vijojë të jetë deputete e Kuvendit të Shqipërisë, edhe me riskun për të mos qenë më pjesë e Partisë Demokratike që e nxori deputete. Hajdari bëhet zyrtarisht deputetja e dytë nga Partia Demokratike që refuzon dhënien e mandatit pas Myslim Murrizit. Hajdari u shpreh se, sipas saj, parlamenti i jep oksigjen demokracisë në vend, e për këtë e ka konsideruar vendimin për mos djegjen e mandatit si atë të duhurin. Vajza e ish-liderit të dhjetorit, Azem Hajdari, zgjodhi Zërin e Amerikës për të bërë publik qëndrimin e saj për qëndrimin në Kuvend. "Unë mendoj se parlamenti i jep oksigjen demokracisë në vend, i jep oksigjen partive politike. Është vendi ku ne përfaqësojmë sovranin. Prandaj duke marrë parasysh që kjo është një përgjegjësi shumë e lartë që ndiej më shtatulla mendoj se qëndrimi në parlament do të ishte vendimi më i duhur", theksoi zj.Hajdari. Ajo bëri të qartë se me këtë vendim, refuzoi të zgjedhë rrugën më të lehtë për të siguruar karrierën e saj politike dhe zgjedhë rrugën që ka të bëjë me të ardhmen e Shqipërisë. "Shqipëria është në një udhëkryq dhe nuk po shikojmë zgjidhje as majtas dhe as djathtas. Nga ana tjetër të gjithë jemi të gjendje të shikojmë se ku është e ardhmja, por e kaluara është mbi supet dhe zemrat tona", u shpreh deputetja Hajdari. Ajo i kujton PD-së se edhe babai i saj, Azem Hajdari, është përrjashtuar dy herë nga kjo parti, ndaj kërkon një vendim të matur prej saj. "Kjo nuk është hera e parë që PD përrjashton anëtarë apo deputetë të saj, ka ndodhur dhe në familjen tim, ka ndodhur me tim atë dy herë. Në ato raste janë pënduar për këtë lloj vendimi. Duhet të jemi shumë të matur para se të marrim këto lloj vendimesh dhe të jemi të kujdesshëm se çfarë mesazhesh ne japim me këto vendime. Nuk mund të ndjek dot një vendim kolegjial që shkon kundër frymës së Kushtetutës së Shqipërisë, kundër intere-



save të Shqipërisë. Më vjen keq nëse zhgënjeh partinë time, por unë do të zgjedh interesin e Shqipërisë. Gjërat janë në ajër dhe nuk dihet se çfarë do të ndodhë. Do kem një marrëdhënie normale me kolegët", tha zj.Hajdari. Rudina Hajdari, vajza e Azem Hajdarit, është

kështu e dyta në listën e PD-së, pas deputetit Myslym Murrizi, që nuk pranon të djegë mandatin. Ky i fundit u përrjashtua nga partia pas marrjes së këtij vendimi, ndërsa nuk dihet ende se si do të veprojë me deputeten Hajdari. Edhe pse e kaloi për një kohë të gjatë në heshtje, ven-

DEKLARATA
"Unë mendoj që parlamenti i jep oksigjen demokracisë në vend, i jep oksigjen partive politike. Është vendi ku ne përfaqësojmë sovranin. Prandaj duke marrë parasysh që kjo është një përgjegjësi shumë e lartë që unë ndiej mbi shtatulla, mendoj që qëndrimi në parlament do të ishte vendimi më i duhur", tha Rudina Hajdari.

dimi i saj ishte i pritshëm nga subjekti i saj politik. Eksponentët e Partisë Demokratike kanë paralajmëruar se ndaj saj do të mbahet i njëjti qëndrim si me Murrizin për shkeljen e vendimit politik, megjithatë mbetet të pritet se çfarë do të vendosë kryesia e kësaj partie.



Gazmend Bardhi: Nga sot Rudina Hajdari nuk përfaqëson më PD-në

Rudina Hajdari nuk përfaqëson më Partinë Demokratike. Lajmin e ka bërë të ditur Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale ku ai bën të ditur se pas deklarimit publik të Hajdarit për të mos dorëzuar mandatin ajo nuk përfaqëson më PD-në. "Vendimi i Rudina Hajdarit është personal. Mandati është i demokratëve! Është e qartë se nga sot ajo nuk përfaqëson më Partinë Demokratike në parlamentin e krimit dhe për pasojë nuk është më as anëtare e Këshillit Kombëtar të PDSH. Kaq majfton! Në rastin e Rudina Hajdarit, çdo vendim statutor është i panevojshëm, sepse formalisht ajo nuk rezulton e regjistruar si anëtare e Partisë Demokratike", - shkruan Bardhi. Por kjo sipas tij nuk prek figurën dhe kontributin që ka dhënë babai i saj, Azem Hajdari për Partinë Demokratike. Sipas tij Azem Hajdari ka qenë, është dhe do të mbetet simbol i demokracisë dhe historisë së Partisë Demokratike. "Beteja dhe amaneti i tij për liri dhe demokraci është sot më aktual se kurrë, kur Shqipëria rrezikohet nga një qeveri ilegjitime, kriminale dhe e korruptuar. Për këtë amanet të Azem Hajdarit foli Kiri Hajdari në protestën e 5 marsit, përkras demokracitëve që dorëzuan mandatet e deputetëve. Sakrificia sublime e Azem Hajdarit nuk do të shkojë dëm", - shkroi Bardhi.

Protesta në Fier, PD: Policia gati arrestimin e 80 qytetarëve

Partia Demokratike pretendon se Policia e Shtetit ka një listë me mbi 80 persona, që pritet të arrestohen sipas tyre, për protestën e dhunshme në 9 mars, në qytetin e Fierit ku kryeministri Rama ishte për një sërë aktivitetesh. Kreu i degës së PD-së në Fier, ish deputeti Luan Baçi, publikoi dje një listë që sipas tij janë emrat që policia do të arrestojë. Mes emrave që PD publikon janë ish-deputetë, si Kejdi Mehmetaj e LSI etj., që ishin në protestën e Fierit. Sipas PD-së, Luan Baçi ka siguruar listën e policisë me mbi 80 emra dhe akuzon policinë se kërkon të arrestojë edhe qytetarë që nuk kanë qenë në protestë për t'u futur frikën të tjerëve për të frenuar pjesëmarr-



rjen në protestën e 16 marsit që opozita joparlamentare do të mbajë para Kryeministrit. "Protestuesit janë me mijëra. Ku do t'i mbani? A ka vend në burgjet tuaja për të gjithë popullin?", shprehet Baçi, i cili e cilëson aksionin e policisë një hakmarrje politike të Edi Ramës. "I bëj thirrje Drejtorit të Përgjithshëm të Pol-

PROTESTA
Partia Demokratike organizoi të shtunën një protestë në Fier, kundër vizitës së kryeministrit Rama në këtë qytet ku pati dhe konfrontim me policinë.

icisë, mos i terrorizoni qytetarët fierakë. Ata protestuan për më shumë punë, siguri, për varfërimin e tyre dhe arsyeja e vetme është ky Kryeministër ilëgjitim", shprehet z.Baçi. Në listën që PD pretendon se janë emrat që policia do të arrestojë, është edhe kryebashkiaku i Mallakastrës, Agron Kapllanaj.

"Shitblerja", Vasili: Çdo personazh vendas apo i huaj të mbyllë gojën

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili denoncoi aktin e shitblerjes së votave nga PS, të ndodhura sipas tij në zgjedhjet e vitit 2017. Nëpërmjet një postimi në "Facebook", Vasili ka publikuar edhe një raport të OSBE-ODIHR, në të cilin thuhet se PD dhe LSI denonconan vjedhjen e votave në atë periudhë. "LSI dhe PD demaskan shitblerjen e votës në zgjedhjet e 2017, vetëm PS kishte zero pretendim!! Kryeministri i prodhuar me votat e kriminelëve në 2017 nuk pati asnjë pretendim për zgjedhjet dhe shitblerjen e votës, sepse ishte frymëzuesi dhe përfituesi i vetëm i saj. Megenëse ky i inkriminuar gjer në fyt, ka dalë dhe llap lart e poshtë për zgjedhjet e 2017, po i kujtoj atij dhe të gjithëve si ai, produkte po njëlloj të parave kriminale, se çfarë thotë OSBE-ODIHR në raportin final për zgjedhjet politike qershor 2017", - shprehet z. Vasili.





Disa ditë më parë, kryeministri Edi Rama gjatë një interviste për mediat italiane foli për interesim të Rusisë për protestat dhe zhvillimet politike në vend. Dhe këtu ai iu referua faktit që televizioni shtetëror rus "RusiaToday" kishte transmetuar live një nga protestat e opozitës para Kuvendit. Ndërkohë që në sinkron mbi këto pohime ka qenë dhe kreu i Shërbimit Informativ Shtetëror Helidon Bendo. I ftuar në Komisionin e Sigurisë për të prezantuar raportin e veprimtarisë një vjeçare të institucionit që ai drejton, Bendo është shprehur se ka përpjekjet për të rritur influencën ruse në Shqipëri. Sipas Top Channel ajo çfarë Helidon Bendo ka ndarë me deputetët ishte edhe shqetësimi për tentativat e Rusisë në rritjen e influencës në Shqipëri. "Nga analiza e të dhënave për vitin 2018 vërejmë një rritje të tentativës nga Rusia për ta shtuar, influencën në vendin tonë" - mësohet të jetë shprehur Bendo i cili nuk ka dhënë detaje të aktorëve që po përdor Moskë për rritjen e kësaj influencë. Por për shkak të kësaj shmangie deputetët prezent në këtë mbledhje mësohet se kanë insistuar duke pyetur kreun e SHISH nëse influenca ruse shkon deri në nivele të larta të politikës shqiptare. Kësaj pyetje ai i ishte përgjigjur prerë jo, duke shtuar se nuk ka informacione që e

Kreu i SHISH ka raportuar në Kuvend mbi punën 1-vjeçare të këtij institucioni

Raportimi në Kuvend, SHISH: Ka rritje të influencës ruse në Shqipëri

Raportimi i Bendos vjen pas deklaratave të Ramës



ÇFARË THA RAMA PËR NDIKIMIN RUS NË SHQIPËRI?

Kryeministri Edi Rama foli pak ditë më parë në mediat italiane për protestat e opozitës në Shqipëri, ndërsa hodhi dyshime edhe për ndikime të Rusisë në to. Ai deklaroi se qeveria nuk ka fakte për këtë gjë, por solli ndër mend faktin se një nga protestat e opozitës ishte transmetuar edhe nga televizionet ruse. "Ne nuk kemi fakte konkrete, por shumë të dhëna: Televizioni rus ka transmetuar drejtpërsëdrejti protestat, por nuk ka asgjë për t'u befusuar. Moskë ndjek interesat e saj dhe Shqipëria brenda Bashkimit Europian nuk ndodhet në mesin e tyre", - u shpreh Rama.

kamerave. Këtë kërkesë të Qefaliaj e mbështeti edhe kryetarja e Komisionit Ermone-la Felaj, e cila theksoi se e mbështet propozimin e deputetit Qefalia. Por Helidon Bendo u shpreh se raportit ishte i klasifikuar dhe se seanca duhet të bëhej pa praninë e medias. Gjithsesi ai premtoi se një përmbledhje e raportit vjetor të SHISH do të ishte i aksesueshëm për publikun. Ndërkohë që mësohet se një prej deputetëve nuk është lejuar të marrë pjesë në këtë mbledhje pasi nuk ishte pajisur ende me certifikatë sigurie për të aksesuar informacionin të klasifikuar sekret. Ky është raportimi i parë që Helidon Bendo bën si drejtori i SHISH para Komisionit të Sigurisë që nga koha që ai mori detyrën e drejtorit të këtij institucioni.

vërtetojnë apo bëjnë të dyshohet për këtë. I pranishëm në këtë mbledhje ka qenë edhe deputeti demokrat, Myslim Murrizi, i cili nuk pranoi të lërë mandatin si kolegët e tij demokratë. Ai mësohet se ka shprehur shqetësimin lidhur me situatën në Policinë e Shtetit dhe prezencën sipas tij të

grupi oficerësh të korruptuar në të. Por edhe këtij interesi, kreu i SHISH i është përgjigjur shkurt se analizi mi i fenomeneve të tilla nuk është objekt i punës së institucionit që ai drejton. "Ne nuk mund të analizojmë veprimet në grup, por mbledhim informacion të personalizuar. Nuk

na rezultojnë që në policinë e shtetit të ketë një grup oficerësh të korruptuar", - citohet të jetë përgjigjur Helidon Bendo. Deputeti Xhemal Qefalia në njëjtë të raportimit kërkoi nëse ndonjë pjesë e raportit nuk përmbante informacion të klasifikuar, apo të dhëna bëheshin në praninë e

TENDER NOTIFICATION

PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE) TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for pest monitoring and control for premises (3D Service).

TIA is looking to contract a company to undertake these services that will consist in general terms of: Pest monitoring and control service for disinfection, dissection and deratization (3D) service and to maintaining a good level of hygiene, very good sanitary conditions, healthy and clean environment, safe operational premises, in order to prevent as well the spread of the infection or contamination and any animal hazard within TIA premises.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e-mail, to all below e-mail address, until 20 March 2019.

Upon receipt of the e-mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form.

The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e-mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked

"PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)"
The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 March 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvjoka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

TENDER NOTIFICATION

STAFF TRANSPORT SERVICES TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Staff Transport Services for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: srada@tirana-airport.com; ialimema@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com, request for information for "Staff Transport Services".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail. This tender will be organized in two phases:

1. In the first phase, companies will need to present: references though similar services performed for other companies, list of vehicles, respective licenses.
2. In the second phase, short listed companies will need to submit their financial offer.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Staff Transport for Tirana International Airport'.

The address for submission of offers is:
Tirana International Airport sh.p.k
Procurement Department
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of samples at the above address is **12:00 hrs. on 21 March 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
srada@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com
apalushi@tirana-airport.com

Kontributin kryesor e japin femrat dhe bujqësia

Nis rritja, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0,1

Treguesi i papunësisë shënon rritje të lehtë në tre muajt e fundit të vitit të vitit 2018. Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, në tremujorin e katërt 2018, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 12,3 %. Në terma vjetorë, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 1,1 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0,1 pikë përqindje. Shkalla zyrtare e papunësisë për meshkujt është 12,5 % dhe për femrat është 11,9 %. Shkalla e papunësisë për femrat është 0,6 pikë përqindje më e ulët sesa për meshkujt. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017, shkalla e papunësisë për meshkujt ka rënë me 1,2 pikë përqindje, ndërsa për femrat ka rënë me 1,0 pikë përqindje. Në tremujorin e fundit, treguesi i papunësisë për femrat është rritur në raport me tremujorin e mëparshëm, duke

POPULLSIA EKONOMIKISHT JO-AKTIVE

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018, 18,1 % e popullsisë ekonomike jo-aktive dhe në moshë pune (15-64 vjeç) ishin duke përbushur detyrat shtëpiake, 12,8 % e saj ishte në pension ose pension të parakohshëm, ndërsa 10,9 % në paafësi të përhershme.

dhënë ndikim në treguesin total, ndërsa për meshkujt ka vijuar rënien. INSTAT raportoi rënie të punësimit në bujqësi dhe rritje në sektorin e industrisë dhe shërbimeve. Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë është 22,3 %. Në terma vjetorë shkalla e papunësisë së të rinjeve shfaq tendencë në rënie. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2017, shkalla e

papunësisë për të rinjtë në tremujorin e katërt të vitit 2018 është 2,3 pikë përqindje më e ulët. Krahasuar me tremujorin e tretë 2018, shkalla e papunësisë për të rinjtë ka pësuar një rënie prej 0,9 pikë përqindje. Shkalla e papunësisë për grup-moshën 30-64 vjeç është 9,2 %. Në terma vjetorë ky tregues pësoi një rënie prej 1,3 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e

mëparshëm për këtë grup-moshë shkalla e papunësisë u rrit me 0,3 pikë përqindje. Sipas INSTAT, Në tremujorin e katërt 2018, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 60,0 %. Gjatë këtij tremujori, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2017, numri i të punësuarve gjithsej u rrit me 1,6 % dhe krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2018, ky tregues u rrit me 0,3 %. Në tremujorin e katërt 2018, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 12,3 %. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2017, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 1,1 pikë përqindje. Krahasuar me trem-



ujorin e tretë 2018, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0,1 pikë përqindje. Në tremujorin e katërt të vitit 2018, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 68,7 %. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2017, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 1,3 pikë përqindje më e lartë. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm ky tregues ka pësuar një rritje prej 0,4 pikë përqindje. Për

femrat, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 60,6 %, ndërsa për meshkujt ky tregues është 76,9 %. Për meshkujt, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 16,3 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për femrat është rritur me 2,2 pikë përqindje dhe për meshkujt është rritur me 0,5 pikë përqindje.

Treguesit për tremujorin e katërt, bankerët, profesioni më i paguar

INSTAT: Paga mesatare bruto u rrit me 3.4%

Punonjësit në bujqësi, me 31 mijë lekë në muaj

Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të katërt 2018, është 52.312 lekë, duke u rritur me 3,4 % krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, raportoi INSTAT në një publikim të posaçëm për pagat. Puna në bankë, apo në një shoqëri sigurimi është sot më e paguara në vend, sipas INSTAT. Paga mesatare në sektorin bankar dhe atë të sigurimeve është 111.6 mijë lekë sipas të dhënave të INSTAT, ose rreth një mijë dollar në muaj.

TË DHËNAT

Gjatë tremujorit të katërt 2018, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në sektorin e aktiviteve financiare dhe të sigurimit është 113,4 % më e lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar, ndërsa në grupsektorin e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit është 28,6 % më e ulët, raportoi INSTAT. Gjatë tremujorit të katërt 2018, paga mesatare bruto për grup-aktivitetin Arte, argëtim dhe lodhje;



Aktivitetet të tjera shërbimi, ka rritjen më të madhe prej 10,3 % krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, ndërsa ndërtimi është i vetmi grup-aktivitet që ka ulje prej 1,2 %. Sipas të dhënave të INSTAT gjatë tremujorit të katërt 2018, paga mesatare mujore bruto, për një të punësuar në grup-profesionin e ligvënësve, nëpunësve të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorëve ekzekutivë është 94,8

% më e lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar. Në vlerë absolute, paga minimale në këtë sektor është 101,8 mijë lekë. Paga për grup-profesionin e Teknikëve dhe specialistëve në zbatim ka rritjen më të madhe prej 7,1 % gjatë tremujorit të katërt 2018, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar (në vlerë absolute arriti në 59,3 mijë lekë), ndërsa për grupprofesionin e të punësuarve në Forcat e armato-

surra ka uljen më të madhe, prej 2,2 %. Grup profesioni i tretë më i paguar në vend është informacioni dhe komunikacioni me rreth 78 mijë lekë në muaj, i ndjekur nga specialistët me arsim të lartë, që marrin mesatarisht rreth 70 mijë lekë në muaj. Më pak paguhen punonjësit në bujqësi, me 31 mijë lekë në muaj, të ndjekur nga punonjësit elementarë, po me rreth 31 mijë lekë në muaj.

INFORMACIONI

Denaj inspekton Tatimet Tiranë Ministrja: 90% e veprimeve online

Ministrja e Financave Anila Denaj ka inspektuar të hënën Drejtorinë Rajonale të Tatimeve të Tiranës. Tashmë administrata tatimore kryen në rrugë elektronike rreth 90% të veprimeve me subjekt, kohë e kursyer, që sipas Denajt, duhet të shfrytëzohet nga nëpunësit për të asistuar bizneset e individët. Ajo tha se tashmë administrata tatimore ka më shumë kohë në dispozicion për të zgjidhur problemet e subjekteve, ndërkohë që informacioni i mbledhur në rrugë elektronike është i vlefshëm për të kuptuar ku duhet ndërhyrë e çfarë duhet përmirësuar. Denaj theksoi se dhixhitalizimi i punës së administratës ka lehtësuar procedurat për bizneset, ka ulur korrupsionin, ashtu si dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë të klima e biznesit.



Tatimet: Arkëtoi 94.5 miliardë lekë, nga 724 tatimpagues

Drejtorja e Tatimeve njofton se Drejtorja e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka pasur një performancë pozitive sa i përket të ardhurave të realizuara në vitin 2018, krahasuar me vitin paraardhës, si dhe ka vijuar më të njëjtat ritme edhe në dy muajorin e parë të vitit 2019. Për këtë qëllim është përzgjedhur si "Drejtorja e muajit". "Referuar të dhënave, kjo drejtori, ka arkëtuar të ardhura tatimore në total rreth 94.5 miliardë lekë ose rreth 0.5% më shumë sesa ishte planifikuar në vitin 2018 dhe rreth 5.9 miliardë lekë më shumë sesa fakti i vitit 2017. Drejtorja e Tatimpaguesve të Mëdhenj aktualisht ka në administrim 724 tatimpagues. Kjo drejtori ka pasur performancë të mirë edhe sa i përket shërbimit ndaj tatimpaguesve, duke vendosur një mënyrë komunikimi të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, përmes informimit periodik, me qëllim nxitjen e vetpërmirësues, rritjen e treguesve të mbledhjes së borxhit, moslejimit të krijimit të borxhit të ri, si dhe intensifikimit e monitorimit të kontrollit" njoftojnë Tatimet. Referuar njoftimit, për Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, ndër objektivat kryesorë të këtij viti janë: ruajtja e treguesve pozitivë, rritja e nivelit të përbushjes vullnetare të tatimpaguesve, informimi i tatimpaguesve, por mbi të gjitha trajtim i njëjtë dhe korrekt i tyre.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbartimit "BAILIFF SERVICE E HOXHIA" sh.p.k. njofton Shpalljen e Ankandit të III (tretë), për shitjen e pasurisë LULLISHTE, me sip. 3.400 m², Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 3271, Vol. 1, Fage 221, ndodhur në Fier-Shëngj Lushnja, në pronësi të: Z.Bejram Selfer Skraçi, i datë dëgjës 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **1.713.600 (një milion e shtatëdhjetë e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **12.03.2019**, ora 16.00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbartimit "BAILIFF SERVICE E HOXHIA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: shurmbh@hotmail.com

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbareus gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 05.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/264/ND+1-2, ZK. 8250, me sipërfaqe 137 m² me adresë Tiranë, në pronësi Z.Bujar Musa Kajtazi me vlerë fillestare në ankand 69,216 (Gjashtëdhjet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.

Kika: Tarifa nuk është e rregulluar me ligj, as me vendime qeverie apo këshilli bashkiak

Abuzimi me tarifën në Sharrë, ndërtuesit: Si duhet ndryshuar

Vendimi nuk është konsultuar me shoqatën e ndërtuesve

Tarifa prej 480 lek/ton për dherat që ndërtesit detyrohen të shkarkojnë në landfillin e Sharrës në favor të koncesionarit 'Integrated Energy BV' është një tarifë e pakonsultuar me shoqatën e ndërtuesve dhe që shumë shpejt do të kthehet në boomerang. Kështu shprehet ndërtuesi Avenir Kika, i cili shton se industria e ndërtimit është një nga aktivitetet me më shumë të punësuar dhe që rrit të ardhurat në buxhet. "Shoqata e ndërtuesve asnjëherë nuk ka qenë pengesë që në Shqipëri të rriten të ardhurat e buxhetit, të rriten punësimi, por gjithmonë ajo kur është pyetur ka dhënë kontributin më të mirë. Me gjithë masat e fundit që janë marrë shoqata nuk është pyetur deri në ligjet e fundit ka një shkëputje midis pushtetit qendror dhe shoqatës. Një moskomunikim, i cili duhet të rivendoset dhe të ketë dialog." -shprehet Kika **ZGJIDHJA**



që detyron ndërtuesit të paguajnë tarifën prej 480 lek/ton për dherat që shkarkojnë në landfillin e Sharrës, ndërtuesi Avenir Kika e sheh tek ligji për hartimin e të cilit duhet të punojnë pushteti vendor dhe ai qendror në



DENONCIMI

Prej disa ditësh kompani të ndërtimit dhe shoqata të biznesit po denoncojnë një tarifë që prej më se 7 muajsh i paguajnë koncesionarit për të depozituar në landfill dherat e pakontaminuar. Ky vendim i pashkruar sipas ndërtuesve nuk bazohet në direktivën e Bashkimit Europian sipas së cilës, dherat e gëmuara gjatë aktiviteteve ndërtimore janë të pakontaminuara dhe si të tilla nuk duhet të cilësohen inerte, por një mall që mund të përdoret edhe për veprimtari të tjera.

konsulencë me vetë ndërtuesit. Ndaj ai kërkon një tregëzë ku të jenë së bashku bashkia, Ministria e Mjedisit dhe shoqata e ndërtuesve. "Jam personalisht i mendimit që ky element nuk është i rregulluar me ligj dhe as me vendime qeverie dhe as me VKM të këshillit bashkiak dhe të gjitha këto duhet një ri rregullim ligjorë në të cilën duhet të jenë tre aktorë kryesorë Ministria e Mjedisit, shoqata e ndërtuesve dhe Bashkia ku aktorët tre palësh duhet të ulen me njëri-tjetrin e të rregullojnë këtë problem që po agravohet gjithnjë e më shumë", -tha Kika. Sipas direktivës së Bashkimit

Europian dherat e gëmuara gjatë aktiviteteve ndërtimore janë të pakontaminuara dhe si të tilla nuk duhet të kategorizohen si inerte, por një mall që mund të përdoret edhe për veprimtari të tjera. Ndaj ndërtuesi Kika thotë se këto dhera të pakontaminuara nuk duhet të çohen në landfill, por të investohen dhe për këtë, duhet bashkëpunimi i shoqatës së ndërtuesve me pushtetin lokal. "Ndërkohë me direktivën e BE dherat e pastra shtresat e pastra, 20-30 centim shtresa poshtë është dhe i pastër, i cila në të gjithë botën përdoret për rregullim e buzëve të lumenjve, shpatet e maleve, rregullimin e pyjeve të

gjitha këto janë të mundshme 100% të rregullohen me një bashkëpunim dhe marrëveshje me shoqatën e ndërtuesve lokale dhe pushtetin vendor. Që do të thotë Tirana ka 15 njësi administrative që janë në periferi të saj dhe ka nevojë të tilla shoqata e ndërtuesve bën një kontratë me këto dhe sipas nevojave të tyre çohet dheu aty ku duhet", -vijoi ai

KONCESIONI

Përcaktimi nga koncesionari i Sharrës dhe Ministria e Mjedisit i tarifës shtesë dhe pranimi i saj nga Bashkia e Tiranës, është cilësuar nga përfaqësues të bizneseve në vend si një vendim skandaloz, me natyrë klienteliste dhe korruptive.

Raporti i Ministrisë së Bujqësisë

Subvencionet për fermerët arritën 16 mln euro më 2018

Ministria e Bujqësisë raportoi se ka shpërndarë gjatë vitit 2018 mbi 1.8 miliardë lekë ose 16 milionë euro subvencione për fermerët. Shpërndarja u krye për 93% e fondit të planifikuar për vitin 2018, i cili ishte më shumë se 2 miliardë lekë. Gjatë vitit 2018 kanë aplikuar rreth 6 203 aplikantë dhe pas procesit të verifikimit të dokumentacionit, verifikimit në terren, u kualifikuan dhe u paguan 4 053 fermerë dhe subjekte agropërpunuese. Në skemat direkte përfutuan 3 940 aplikantë me rreth 642 milion lekë dhe në skemën e investimeve përfutuan 105 aplikantë me rreth 1 002 milion lekë. Nga buxheti i 2018 për masat kombëtare u paguan dhe detyrimet kontraktuale për subvencionimin e normës së interesit, bazuar në VKM përkatëse të viteve të kaluara. Gjatë gjithë procesit të aplikimit fermerët u asistuan nga specialistët e ekstensionit të bujqësor. Për rikonstruksionin dhe pajisjen e 15 zyrave të aplikimit dhe informimit (Agro-



pikat) të aplikantëve në skemat mbështetëse kombëtare të bujqësisë dhe zhvillimit rural u alokuan 56,6 milion lekë, nga të cilat u realizuan 47 milionë lekë ose 83% e fondit. Diferenca është si pasojë e procedurave të prokurimit. Ministria e Bujqësisë shpjegoi në një raport të posaçëm për këtë qëllim se Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2018, për masat kombëtare u përdor për rritjen e konkurrencës së produkteve bujqësore, nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të mbjella me kultivarë të kërkuar nga tregu, përmirësimit të

teknologjive të kultivimit, certifikimit të produkteve, rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve të grumbullimit, ruajtjes, pastrimit, seleksionimit, paketimit dhe përpunimit të tyre. Një pjesë e fondeve shkoj për përmirësimin e zinxhirit të sigurisë ushqimore të produkteve blegtorale, nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikuara të lindjeve të reja, pagesave për dorëzimin e qumështit cilësor, investimeve në theortore, në pikat e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve, makineri dhe pajisje në fermat blegtorale.

unicef | for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)
Albania Country office

CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST

The UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF), ALBANIA Country Office, would like to announce a Call for Expression of Interest addressed to Civil Society Organizations (CSOs) for a prospective partnership with UNICEF Albania Country Office in the implementation of the activity "**Supporting local level implementation of Criminal Justice for Children Code**".

For further details on the required partnership and on how to respond to the Call, please consult UNICEF Albania (<https://www.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers>) and UN Albania (www.un.org.al) websites.

Applications from interested CSOs must be delivered to UNICEF Tirana Office not later than **27 March 2019, at 16:30 hr.**

Applications must be submitted in a sealed envelope, clearly marked "**Call for Expression of Interest - EOI-ALBA-2019-001 - Supporting local level implementation of Criminal Justice for Children Code**".

at the following address:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rruga "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë,
Tiranë, Albania
Tel.: + 355 4 454 8400
Website: www.unicef.org/albania

VLORE - Afro një muaj pas atentatit me dy të vranë e të plagosur të ndodhur në qytetin e Vlorës, Gjykata e Apelit ka rrezuar kërkesën për aplikimin e një mase të butë sigurie për të mbijetuarin e vetëm të kësaj ngjarjeje. Bëhet fjalë për 42-vjeçarin, Armando Sulejmani, i cili do të qëndrojë në burg pasi mbrojtja nuk arriti të argumentojë ankimmimin dhe nuk bindi gjykatën. Ai akuzohet për "Mbajtja pa leje dhe



Armando Sulejmani

Atentati mafioz me 2 të vranë e 1 të plagosur, Apeli në "Arrest me burg" të mbijetuarin "Çipuri"

prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municioneve" dhe dyshohet se ka qenë dhe shënjestra e atentatit për shkak të së kaluarës së tij dhe precedentëve. Mësohet se "Çipuri" nuk ka pranuar të japë asnjë detaj që ndihmon hetimin. Edhe pse policia shoqëroi rreth 17 persona në lidhje me ngjarjen e 17 shkurtit,

nuk arriti të bjerë në gjurmë të autorëve të krimit. Në vendngjarje janë gjetur 90 gëzhoja dhe dyshohet se viktimave u është ngritur pritë. Në momentin që kanë mbërritur në zonë makina e viktimave, atentatorët e kanë ndjekur nga pas për disa metra dhe kur është hapur zjarr kanë ecur paralel. Viktimat

Arjan Hasanaj, 45 vjeç dhe Oest Rexho 37 vjeç nuk kanë pasur mundësi reagimi. Vendi është zgjedhur nga atentatorët, pasi i gjithë aksi nuk ka kamera sigurie. Gjithashtu, mësohet se në makinën e vrasësve, e cila rezultoi e vjedhur, janë gjetur 3 armë automatike, por asnjë provë identifikuese.

Prokuroria kundër rihapjes së çështjes, vendimi pritet të jepet më 18 mars

Dosja "Hajdari", Izet Haxhia në Apel: Dua të dëgjohem dhe të paraqes provat

"Deri më tani nuk më ka dëgjuar asnjë gjykatë, jam dëshmitar i dorës së parë"

TIRANË

Mesditën e djeshme, në Gjykatën e Apelit të Tiranës nisi gjyqi për Izet Haxhinë, i dënuar me 25 vite burg për vrasjen e Azem Hajdarit. Me tre gjyqtarët e deleguar nga Krimet e Rënda do të shprehet nëse do të pranojë apo jo kërkesën e Izet Haxhisë për të riçelur procesin e vrasjes së Azem Hajdarit. Seanca është shtyrë, ndërsa më 18 mars, kjo gjykatë do të shprehet nëse do të pranojë apo jo kërkesën e Izet Haxhisë për të riçelur procesin e vrasjes së Azem Hajdarit. Në seancën e djeshme, Haxhia përmes apelimit kërkoi rigjykimin e tij, pasi pretendon se është i pafajshëm. Pikërisht këtë linjë qëndrimi ka mbajtur edhe avokati i tij në seancë, kur tha se kërkojnë të faktojnë pafajësinë e Izet Haxhisë. Një gjë e tillë sipas tij mund të arrihet me rihetimin e çështjes. Ndërkohë që prokurorja Fatjona Memcaj është shprehur se nuk ka vend për riçeljen e çështjes. Ajo ka kërkuar të argumentohet shkaku pse kërkohet riçelja e procesit, duke kërkuar në fund rrezimin e kërkesës. Vetë Haxhia ka kërkuar të dëgjohet, gjë e cila sipas tij nuk ka ndodhur nga asnjë gjykatë. Ai thotë se ka prova në lidhje me ngjarjen dhe se do t'i paraqesë.



Izet Haxhia

"Deri më sot s'jam dëgjuar nga asnjë gjykatë. Dua të dëgjohem e të paraqes provat e mia. Jam dëshmitar i dorës së parë", - shprehet ai. Më herët Izet Haxhia dhe avokati Bashkim Nikolli kërkuan përjashtimin e trupës gjyqese si Valdete Hoxha, Genti Shala, Astrit Haxhi-

alushi me arsyetimin se kjo trupë nuk mund të garantojë një proces të paanshëm. Ai ka kërkuar të gjykohej nga gjyqtarë që kanë kaluar vetingun. Avokati Bashkim Nikolli, theksoi se ai bashkë me klientin e tij do të kërkojnë që treshja e përcaktuar të zëvendësohet me një

trup gjyqes nga Apeli i rretheve. Sipas avokatit, fakti që bashkëshortja e Azem Hajdarit punon në të njëjtin ambient me trupën gjyqese, kjo tregon se procesi është i cenusëshëm dhe nuk mund të vijohet me këtë metodë gjyqimi, sepse me ose pa qëllim gjyqtarët nuk mund të ga-

DEKLARATA

"Deri më sot s'jam dëgjuar nga asnjë gjykatë. Dua të dëgjohem e të paraqes provat e mia. Jam dëshmitar i dorës së parë", - shprehet ai. Më herët Izet Haxhia dhe avokati Bashkim Nikolli kërkuan përjashtimin e trupës gjyqese si Valdete Hoxha, Genti Shala, Astrit Haxhialushi me arsyetimin se kjo trupë nuk mund të garantojë një proces të paanshëm.

SHKURT

Pjesë e grupit "Bajri", lihet në qeli ish-boksieri Nelson Hysa

TIRANË - Gjykata për Krime të Rënda ka lënë në qeli ish-boksierin e Vllaznisë, Nelson Hysa, i cili u arrestua katër ditë më parë si pjesë e grupit kriminal "Bajri". Ai u kap në një banesë të marrë me qira në zonën e "Komunës së Parisit" në Tiranë në kuadër të operacionit të koduar "Oaz". Që prej shtatorit të vitit 2018, kur u arrestuan 11 anëtarë të grupit "Bajri", Gjykata e Krimeve të Rënda kishte dhënë për Hysën masën e sigurisë "Arrest me burg", ndërsa ai ishte në kërkim. Gjatë veprimeve procedurale, boksierit i'u sekuestrua edhe një automjet luksoz "BMW Seria 3". Hysa ka qenë edhe më herët objekt i policisë, pasi në muajin maj të vitit 2017 i shpëtoi një atentati në Shkodër ku mbeti i plagosur.

Lleshaj: Penalizim çdo shqiptari që nuk deklaron adresën

TIRANË - Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj është takuar dje me prefektët, përfaqësues të Njësisve Vendore dhe të zyrave të Gjendjes Civile për Adresarin dhe listat zgjedhore. Gjatë këtij takimi, ministri apeloj të punohet më shumë në lidhje me adresat. Ai tha se është e papranueshme që një person që mban pasaportë shqiptare të mos deklarojë edhe një adresë të qartë. "Situata është paradoksale, edhe në dokumentet zyrtare nuk vendoset adresa. Po punojmë për një hapësirë e nevojshme ligjore që të mos iu ofrohet shërbim atyre klientëve që nuk kanë adresë. Do ketë probleme dhe për njerëzit që kanë një pasaportë dhe nuk kanë një adresë", - u shpreh Lleshaj.

Ngec në rretjen e vetingut, KPK shkarkon kreun e gjykatës së Tropojës, Dritan Seci

TIRANË - Komisioni i Paruarur i Kualifikimit ka shkarkuar nga detyra kreun e Gjykatës së Tropojës. Dritan Seci me sa duket nuk ka mundur të kalojë me sukses tri shtyllat e rivlerësimit për gjyqtarët, analizën e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësisë profesionale. Procesi i vetingut për Secin u krye nga trupa gjyqese e përbërë nga Roland Ilia, Valbona Sanxhaktari dhe Olsi Komici.

PASURIA

Të dhënat e analizuar nga BIRN tregojnë se gjyqtari Dritan Seci nuk zotëron-

te asnjë pasuri në vitin 2004, kur deklaroi për herë të parë interesat e tij vetjake pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (LLDKPK). Në fund të vitit 2017, pasuria e tij familjare kap vlerën e 20.1 milionë lekëve me një rritje mesatare vjetore prej 1.4 milionë lekësh. Pasuritë e paluajtshme përbëjnë pjesën kryesore të aseteve me 13.7 milionë lekë. Referuar deklaratave të pasurisë, gjyqtari Seci zotëron një apartament dhe një lokal shërbimesh në Bajram Curri si dhe një apartament në Tiranë. Ai deklaroi, gjithashtu,

në total 5.9 milionë lekë likuiditete bankare dhe kurse me cash prej 400 mijë lekësh. Të ardhurat familjare për periudhën deklaruese janë 33.6 milionë lekë. Rreth 53% e të ardhurave kanë si burim aktivitetin e bashkëshortes si farmacist, ndërsa paga nga funksioni i gjyqtarit zë 46.8% në buxhetin e familjes. Përveç analizës për rritjen/uljen e pasurisë, strukturën e aseteve dhe të ardhurave, ky raport paraqet dhe kontrollin aritmetik/logjik të deklaratave të subjektit si dhe "flamujt e kuq" që identifikohen gjatë kontrollit. Nga kontrolli aritmetik/logjik rezultojnë se 14 deklarata e analizuar janë pa diferenca negative mes të ardhurave dhe shpenzimeve. Megjithatë, BIRN identifikoi si "flamur të kuq" mosdeklarimin e të ardhurave nga paga në vitin 2010; ndërkohë që kreu i Gjykatës së Tropojës ka deklaruar kurse familjare në vlerën e 2 milionë lekëve në të njëjtin



Prokurori Dritan Seci, gjatë përballjes me KPK

vit. Duke qenë se ky raport bazohet në të dhëna statistike të analizuar nëpërmjet një databaze, ai nuk nxjerr përfundime mbi pasurinë e subjektit nëse ajo është e ligjshme ose jo, por mëton të informojë publikun mbi pasurinë e deklaruar të zyrtarit publik nëpërmjet një formati të thjeshtë dhe të kuptueshëm grafik.



Protesta e djeshme të "Petro Nini"



Situata e tensionuar te "Petro Nini", Lleshaj liron nga detyra kryepolicin e Tiranës

TIRANË

Tentuan t'u shembnin banesën, familjarët 6 orë përplasje me përmbartesit dhe policinë

Konflikti për pronën, banorët: Kemi 70 vjet që jetojmë këtu, nëse shtëpia prishet, do të flijohemi

Për afro 6 orë, pjesëtarët e disa familjeve protestuan dje për të mbrojtur banesën ku jetojnë prej 70 vitesh pranë shkollës "Petro Nini Luarasi" në Tiranë, pasi tokës ku është ndërtuar shtëpia i ka dalë pronari. Ata bënë qëndresë dhe u përplasën me përmbartesit dhe policinë, të cilët i qëlluan me vezë. Shkas i situatës së tensionuar mes palëve është bërë një vendim gjykatë i formës së prerë për shembjen e ndërtesës. Në momentin që përmbartesit ka shkuar për të nisur nga puna, familjarët kanë rezistuar. Fillimisht, ata janë shtrirë në rrugë në shenjë proteste duke kërkuar që puna të ndalet. Protesta e tyre ka krijuar një situatë të pazakontë, e cila ka sjellë bllokimin e qarkullimit prej rreth një orë pranë shkollës në fjalë. Disa prej familjarëve të përfshirë në përplasje u shoqëruan në polici, ndërsa të tjerë u dërguan me ambulancë për në spital si pasojë e gendjes së vështirë shëndetësore që kaluan nga përshkallëzimi i situatës. Banorët pretendojnë se pronarët e tokës, Aleksandër dhe Ilir Gavoçi, i kanë premtuar se do t'i japë disa banesa, por deri tani nuk është marrë asnjë hap. Përmbarimi i tentuan të futen me forcë në ambientet e shtëpisë duke goditur derën me shufra hekuri në sy të disa fëmijëve. Në këtë moment policia nuk ka bërë asnjë reagim, gjë për të cilën është kritikuar edhe nga ministri Sandër Lleshaj, i cili ka deklaruar se policia ka detyrim ligjor të mbështesë përmbarrimin dhe të tregohet efikas, ku duhet të shmangte incidentet ku ish-in të përfshirë edhe fëmijë. Pas përplasjes së djeshme mes banorëve dhe përmbartesve, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu liron nga detyra kryepolicin e Tiranës, Kastriot Skënderi



REAGIMI I MINISTRI LLESHAJ

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj reagoi dje pas situatës së tensionuar të krijuar në afërsi të gjimnazit "Petro Nini" në kryeqytet, ku përmbartesit kishin shkuar të shembnin një banesë. Gjatë protestës banorët rezistuan e u përplasën me policinë, ndërsa ministri i kritikon këta të fundit, duke thënë se në këtë rast nuk u treguan dinjitozë dhe efikasë. Në një postim në Twitter, ministri shkruan: "Mirëkuptim të plotë për reagimet ndaj pranisë së Policisë Shtetit në ekzekutimin e një veprimi përmbarrimor, mbi një vendim gjykatë të formës së prerë. PSH ka detyrimin ligjor të mbështesë përmbarrimin, por ka edhe detyrimin të jetë dinjitozë dhe efikasë. Kjo s'ka ndodhur në këtë rast!"

KRYEBASHKIAKU VELIAJ

Për përplasjen te "Petro Nini" ka reaguar edhe kryebashkiaku, Erion Veliaj, i cili shprehu gatishmërinë për t'u ofruar menjëherë banesa sociale familjeve në godinën që do prishet. "Bashkia Tiranë është gati që sot t'i ofrojë mbështetje me banesa sociale në kushte shumë më të mira se katet pa leje të gjithë familjeve të prekura nga ky konflikt mes dy privatëve për pronat, kontratat e llogaritë e tyre, pavarësisht vendimit të gjykatës", shkruan Veliaj në Twitter duke nënvizuar se Bashkia nuk është e përfshirë në asnjë nga etapat e këtij procesi, ndërsa konflikti i pronarëve të tokës me banorët e një ndërtese me shtesa pa leje është trajtuar nga Gjykata

Përplasja te "Petro Nini", Rama: Policia e ka detyrim ligjor t'i përgjigjet Përmbarrimit

TIRANË - Kryeministri Edi Rama ka reaguar dje në lidhje me përplasjen e banorëve të zonës së "Petro Ninit" me forcat e rendit dhe përmbartesit për zbatimin e vendimit të gjykatës. Përmes një postimi në Twitter, Rama thotë se qeveria nuk ka asnjë fuqi mbi vendimet e gjykatave. Ndërsa shton se policia, siç ligji e detyron, duhet t'i përgjigjet Përmbarrimit që kishite shkuar me vendim gjykatë për të nxjerrë banorët. "Të trishtueshme pamjet nga rruga e shtëpisë ku kërkohet ekzekutimi i një vendimi gjyq të formës së prerë. Por e trishtueshme edhe se si Kazani i përzierin gjërat pa lidhje! Qeveria s'ka asnjë fuqi mbi vendimet e gjykatave dhe policia e ka detyrim ligjor t'i përgjigjet Përmbarrimit", shkruan Rama.



ar në mënyrë të jashtëligjshme pronën. Mësohet se familjet që jetojnë në banesën që me vendim gjykatë duhet të shembet kishin nisur procese gjyqësore kundër vendimit, por kishin hequr dorë pas premtimit të pronarit për t'u dhënë shtëpi në pallatin që do të ndërtohet, premtim që ata thonë se ai nuk e ka mbajtur duke prishur njëansh-

vitin 1939. "Në këtë banesë jetojmë prej 70 vitesh. Toka e banesës ku banojmë është e shtetit. Nuk i është marrë në vitin 1944. Ai e ka marrë pa

vetëm që iu është sekuestruar prona në 44 dhe unë e liroj shtëpinë", tha familjari. Jo vetëm familjarët, por edhe fëmijët e tyre ishin dje pjesë e protestës. Ulërima dhe të gara shoqëruan rezistencën e tyre ndaj përmbartesve dhe policisë. "Na morën jetën, na pushkatoni", ulërinin zonjat e shtëpisë. Ndërsa banorët protestonin, pranë banesës ka rënë zjarr. Dyshohet se banorët i kanë vënë flakën në shenjë proteste disa mobilieve. "Nëse shtëpia prishet, ne do të flijohemi" kanë kërcënuar familjarët.

PROTESTA

Godina në të cilën jetojnë disa familje, është ndërtuar mbi një truall që me vendim gjykatë i ka kaluar pronarit. Por, banorët pretendojnë se pronarët kanë falsifikuar dokumentet dhe e kanë fitu-



Stafi akademik i "Luarasi" me maturantët e Lushnjës

Rektori Ethem Ruka: Ofrojmë bursa të plota studimi për nxënësit ekselentë

Voltiza Duro

Universiteti që do të ndjekin vazhdon të mbetet zgjedhja më e vështirë për mijëra maturantë. Për t'i ardhur në ndihmë të rinjve, stafi i universitetit "Luarasi", po vijon fushatën e këshillimit të karrierës në shkollat e mesme në mbarë vendin. Këtë të hënë, rektori Ethem Ruka iu ka shpjeguar nga afër rreth 500 maturantëve nga qyteti i Lushnjës, rëndësinë e studimeve të larta për të ardhmen profesionale. Ai ka shpalosur për të rinjtë edhe programet që ofron univer-

"Luarasi" vijon fushatën e këshillimit të karrierës, takim me 500 maturantë

"Arsyet pse duhet të bëheni pjesë e këtij universiteti"

siteti në tre fakultetet e tij. "Djem dhe vajza të reja! Gjej rastin t'ju bëj thirrje që të zgjidhni profesionin tuaj me shpirt, duhet ta doni atë që

do të zgjidhni. Pra, zgjidhni, por këtë zgjedhje bëjeni me mend, por mbi të gjitha mos e humbisni shansin për t'u shkolluar, pasi kjo është

shumë e rëndësishme. Njeriu duhet të jetë i shkolluar, i ditur, pasi në këtë mënyrë është më i mirë për veten, për familjen, për shoqërinë. Të ardhmen tuaj e keni në dorën tuaj, por këtë të ardhme ia u jep vetëm shkolla. Nuk ka një opsion më të mirë sesa shkolla për t'i dhënë njeriut dinjitet", iu bëri thirrje rektori maturantëve.

BURSAT DHE OFERTAT

Më tej rektori tha se të gjithë nxënësit ekselentë do të përfitojnë bursa të plota studimi në këtë universitet. "Pavarësisht gjendjes ekonomike që mund të kenë, nxënësit që janë me nota dhjeta, mund të vazhdojnë studimet e larta në "Luarasi", me një tarifë zero. Këtu keni një fletë që shoqëron broshurën, një fletë kjo promovuese për universitetin tonë. Kushdo nga ju që dëshiron të vijë te 'Luarasi', ka të drejtën të regjistrohet. Kam takuar prindër, që nuk kishin informacion për ofertat promovuese të 'Luarasit'. Do të gjeni të gjitha tarifat, zbritjet, e iu siguroj që nuk keni asnjë kosto shtesë përtej informacionit që ne po iu japim sot", tha Ruka në fjalën e tij. Ky i fundit u bëri ftesë maturantëve të Lushnjës që të bëhen pjesë e 'Luarasit'. "Ne i njohim shumë mirë interesat e studentëve dhe 'Luarasi' është një zgjedhje me të vërtetë shumë e mirë për çdo të ri.

PROGRAMET E STUDIMIT

Universiteti "Luarasi" ofron programe studimi në tre fakultete, përkatesisht në Drejtësi, Ekonomik dhe Teknologji Informacioni e Inovacioni, duke përgatitur kështu profesionistë të



Dje gjatë këshillimit të karrierës me rektorin e "Luarasit"

ZBRITJET

"Pavarësisht gjendjes ekonomike që mund të kenë, nxënësit që janë me nota dhjeta, mund të vazhdojnë studimet e larta në "Luarasi", me një tarifë zero.

Kushdo nga ju që dëshiron të vijë te Luarasi, ka të drejtën të regjistrohet. Do të gjeni të gjitha tarifat, zbritjet, e iu siguroj që nuk keni asnjë kosto shtesë përtej informacionit që ne po iu japim sot", -tha Ruka në fjalën e tij.

kërkuar nga tregu i punës. I pozicionuar në një nga zonat më të preferuara universitare të kryeqytetit, me një infrastrukturë të shkëlqyer dhe kushtet më të mira për mbarëvajtjen e mësimin dhe argëtimin e studentëve, Universiteti 'Luarasi' është një ndër fakultetet që maturantët kanë në opsionet e tyre për të ndjekur studimet e larta. Pas shpalljes së rezultateve

të akreditimit të shkollave të larta publike dhe shtetërore, Universiteti 'Luarasi' akreditohet maksimalisht për gjashtë vite duke u renditur një në katër shkollat e larta më të mira të vendit. Ky certifikim, që dëshmon cilësinë dhe besueshmërinë e lartë të diplomave, është vetëm një nga arsyet përse maturantët preferojnë të studiojnë në universitetin 'Luarasi'.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 9 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 09.03.2019 (përfshirë TVSh-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

Listat e plotë/ Ja kur duhet të paraqiteni pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë

Voltiza Duro

Kempi, zjarret dhe erat e 308 personave të do të kryejnë kontrollet mjekësore

ISSH: Nëse nuk kryeni ekzaminimin, nuk mund të përfitonit pensionin

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka zbardhur emrat e personave që do të nënshtrohen kontrolleve mjekësore në KMCAP...

dëmtime fizike apo gjytime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti.

banimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitim të pensionit të invaliditetit.

vërtetojnë moshën e identitetin, ato që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara e gjendjen shëndetësore.

iu njofton datën për të kaluar në KMCAP, ose i kthen mbrapsht dokumentet për pasaktësi.

kryetari i KMCAP-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurtit vendimet e tyre. Kundër këtyre vendimeve të sëmurtit mund të kërket tek KMCAP-i epror.

LISTA ME EMRAT E 308 PERSONAVE QE DO TE KRYEJNE KONTROLLET MJEKESORE

Table with 10 columns: No., Emri, Mbiemri, KMCAP, Data, Ora, Rrethi, and 4 columns of personal details (Name, Surname, Birth Date, Birth Place, Gender, Address).

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

cilësojë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankimmuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkrongjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të shpronësuar nga nënshtronen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Fier	Fitim Numani	230	19700
Korçë	Eduard Evangjeli		86.6
Korçë	Llambi Tërova		69
Shkodër	Ramadan Mustaf Gjoka		11500
Shkodër	Fadil Hasani		2000
Shkodër	Trash. Lahi	1200	6500
Fier	Ferit Gjata	4507	2543
Shkodër	Ndrek Gjoka		500
Fier	Nureidin Mukaj		3800
Korçë		1870	2929
Korçë	Harif Hidri	2030	1197
Korçë	Hysen Shahini, Rabushe Shahini		569
Korçë	Avdyll Bajram Fero	815	1144
Gjirokastrë	Athina Krokari	5700	650
Gjirokastrë	Medi Musaraj		513

Gjirokastrë	Bashkim Sheme	9916	300
Korçë	Zija Demir Nastimi	736	264
Kukës			10424
Gjirokastrë	Adil Spahiu	483	735
Gjirokastrë	Samit Rexhepi	3666	2658
Gjirokastrë	Barjam Mehmeti	1078	776
Korçë	Hekuran, Fatmir, Halit Hoxha	8550	1690
Korçë	Xhevair Pasho	3820	180
Korçë	Vasfi Beqari		1434
Korçë	Kalimaq Bicollli		2370
Korçë			340
Korçë	Sami Vënxha	1270	10260.2
Korçë	Ali Selenica	1825	3375
Korçë	Aleksandra Ceno		550
Korçë	Muharem Shurdho	3328	1472
Korçë	Haxhire Herri		3651
Korçë	Gani Bega	787	2893
Tiranë	VERA OSMANAJ	582	671
Durrës	Ismail Beshiri	2672	4136
Gjirokastrë	Tefik Hyseni	9040	960
Tiranë	MERSIN VORPSI	2339	2000
Tiranë	ZENEPE VIKA	7037	3342
Korçë	Ahmet Meçe, Xhemile Meçe		1020
Dibër	XHEVIT DERVISH TOLA		684
Dibër	ARTAN AGIM SHAHINAJ		768

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Elbasan	TAHIR DAJA		2410
Elbasan	SHERIF MIRAKA		8060
Fier	Mark Mali	9450	11280
Fier	Nexhit Malko	6250	1250
Korçë	Kostantina Mrametari, Vasce Bafiqi	20	48
Shkodër	Syrri Borici		162
Tiranë	TOMORR SINA	8843.9	900
Tiranë	TOMORR SINA	6310	0
Fier	Spiro Ziu		10100
Korçë	Idriz Isaku		22
Korçë	Myfit Cuko		425
Tiranë	YMER BREGU	2712	288
Tiranë	HAMIDE TAGA	786.5	278
Vlorë	Spiro Klimi	1145	300
Vlorë	Pilo Bregu		1600
Tiranë	Fanije Velja, Kostandin Velja	30	168
Korçë	Dhioqjen Spirollari		528
Korçë	Ilia Xexo	4198	4802
Shkodër	Fahri Taip Osja	1600	6900
Shkodër	Trash. Kroj	300	3500
Shkodër	Qazim Haruolli		900
Lezhë	Masar Lezha	70	3370
Gjirokastrë	Hamza Karafili		50
Gjirokastrë	Xhelal Spahiu	1552	798
Kukës	Adem Shaban Gashi	1054	3507
Tiranë		860	170
Korçë	Medeat Bylyku	535	1471
Lezhë	Preng Zef Gjeta		45450
Gjirokastrë	Ali Fekush Isufaj		1248
Gjirokastrë	Dule Mecani	747	3471
Gjirokastrë	Guce Haxhiaj		990
Gjirokastrë	Muhamet Merjemaj	1012	600
Gjirokastrë	Abaz Shena	1403	1083
Korçë	Gjergji Faberi		104.5
Vlorë	Lutfie Lagji	50	158
Tiranë	Maliq Cikoja	1670	0
Korçë	Jashar Leci		800
Korçë	Jashar Leci		800
Korçë	Azis Manellari	2355	2005
Tiranë	AGIM BEJA	1920	2180
Korçë	Gjylhare Lytifi Mullaj (Cane)	643	500

Korçë	Gazi Mazelli	1423	770
Korçë	Shefqet Ajçe	1852	1363
Gjirokastër	Habil Bello	3095	1300
Fier	Kozma Rista	8186	47014
Fier	Mustafa Bozgo	835	1289
Fier	Perikli Berbat	474	9326
Fier	BARJAM CANI		2000
Fier	Jashar Lepuri		10030
Fier	Fatmir Shehu		10700
Fier	Vasil Bozo		5100
Fier	Isa Hoxha		5500
Korçë	Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi	176	756
Korçë	Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi	646	1558
Korçë	Filip Klime Petre	1043	293
Korçë		750	608
Korçë	Ligor Çobani		172
Fier	Pulie Bendo		1962
Korçë	Arsa Shegoni	420	104
Elbasan	KAMBER TAFANI	1997	4558
Elbasan	SKENDER BEQIRI	77	492
Fier	Jonuz Tushe	200	1160
Gjirokastër	Mihal Pujo		1250
Gjirokastër	Kostandin Pano		1560
Gjirokastër	Vaqsil Thomollari	2205	11130
Gjirokastër	Mersin Shaho		27000
Korçë			7935
Korçë			1060
Korçë	Agim Dervishi		700
Korçë	Sabri Hyka		2400
Korçë	Pirro Pepo	50	785
Korçë	Marjeta Mitre		56
Korçë			300
Tiranë			4890
Korçë	Nexhmi Hoxhallari		6550
Korçë	Fadil Zerani	755	200
Durrës	Hasan Kalaci		241.28
Durrës			0
Korçë	Magedon Karamina, Zikun Karamina	995.5	513.7
Korçë	Kristo Kamburi	490	111.4
Korçë	Xhevrije Backa	455	455
Korçë		2840	313
Vlorë	Garufi Vasili	950	825
Shkodër	Luigj Tom Lepuri		3400
Shkodër	Trash. Tahiri		6300
Vlorë	Sali Kseno	6300	3060
Vlorë	Jaup Hibro		685
Vlorë	Fatos Mehmeti	2160	300
Vlorë			5000
Vlorë	Alem Alemi		1000
Vlorë	Sadik Tahiraj		1250
Vlorë	Spiro Lamani		950
Vlorë	Panajot Papa	4908	1012
Lezhë	Bardhok Gjeta		0
Fier	Ndino Gjini	10000	1690
Fier	Iljaz Fejzullahu		9120
Fier	Sadik Balla	1800	4200
Fier	Lili Doka		10114
Fier	Bashkim Cela	4650	5814
Fier	Morie Ndreo	1000	2000
Fier	LONI KOCI		10200
Fier	Hysni Arapi	4000	500
Fier	Vasil Hila	1420	5980
Fier	Trifon Duka	1520	7360
Korçë	Safet Diko	377	23
Lezhë	Nikolle Preng Marku(Perleka)	712	1450
Tiranë	EMINE FRASHERI		1000
Fier	Beshir Arapi		3000
Shkodër	Hane Muja	6000	11655
Durrës			0
Elbasan	RIZA KOKLA	2155.4	3244.6
Tiranë	Xhafer Xhameta		10564
Vlorë	Andrea Kajo, Nikolla Kajo	6832	3930
Durrës	Mustafa Pistolja	190	595
Korçë	Thimi Tytymçe	334	266
Shkodër	Veli Suma		0
Durrës	Lusia Zaharian		1024
Durrës	Ibrahim Kaziu	2100	7936
Elbasan	ISAK KARRIQI		10278
Shkodër	Jakin Guraziu		176
Elbasan	ETHEM LLAPUSHI	3297	7746
Korçë	Banush Lumi	394	5606
Korçë	Zymbyle Pellumbi	1358	7522
Shkodër	Fadil Jonuz Kulluri		5000
Shkodër	Gjergj ; Pjeter Pepaj		1000
Durrës	Rifat Malltezi		70
Durrës	Luan Rroshi	1140	735
Durrës	Dardan Domi		100
Durrës	Dardan Domi	3208	1792
Elbasan	Rushan Karaj		1658
Elbasan	Maliq Cekrezi		8250
Elbasan	RASIM BOLLOBANI		8410
Elbasan	Zeni Zeneli		1120
Fier	Bilal Hajredini		2400
Fier	Muharrem Goxhajh		2600
Fier	Vitori Kaldremi		500
Korçë	Gliqirije Mato		1588
Lezhë	Zija Kadija	15765	7735
Korçë	Piro Dine		1330
Korçë	Liri Dika, Naime Dika		1105
Korçë	Alije Meto		1406
Elbasan	HYSNI LLAPUSHI	4364	6886
Korçë	Rifat Backa	1166	904
Korçë	Jashar Lleci	480	920
Korçë	Alie Koçiu	147.5	2708.5
Lezhë	Drita Xhani		306
Tiranë	Hamit Daja	11746	14254
Tiranë	SOTIR KONDI		332
Tiranë	FLUTURA KUMBARO	4067.7	0
Elbasan	SHEQERE DERMYSHI		2120
Gjirokastër	Hetem Xhunga	300	300
Durrës		2452	348
Korçë			3500
Korçë	Jashar Lleci	836	275
Tiranë	HAMIDE, ALI, SHEMSHEDIN, MUSTAFA, XHAFERR, SHEH N	7941	2800
Tiranë	VANGJEL QIRAXHI	2765	5235
Korçë	Belul Sula, Emine Sula, Shaban Sula	6114	3886
Korçë	Hava Alla, Idris Alla, Xhemile Alla	2840	2010
Elbasan	Shaziman Karriqi		10159
Gjirokastër	Fotaq Mavo	3035	800
Korçë	Shyqyri Hoxha		2009
Kukës	Skender Palushi	468	1082
Kukës	Shefit Palushi	600	103
Kukës	Qerim Halil Hajrulla dhe Bilal Cena		1600
Vlorë	Sofia Shqevi	5000	0
Vlorë	Sofia Shqevi	5000	0
Vlorë	Ibrahim Mustafa	200	2660
Vlorë	Xhevair Skëndo		400
Vlorë	Haxhi Bisha	196	2210
Vlorë	Fuat Halimi, Menyrr Halimi		10000
Vlorë	familja Tigani	1320	20000
Vlorë	Fetie Çipi		2400
Vlorë	Hamdi Mezin		8400
Durrës	Kada Kamber Haxhia		25000

(vijon)

Mes radios dhe muzikës, të fshehtat e projekteve që do bëjnë bujë

Ilda

Mërkuri:

Kur dhimbja kthehet në art

"Nuk e kam përdorur kurrë imazhin për marketing"

Egla Xhemali

Ilda Mërkuri është vajza që ju rrëmbeu zemrat shqiptarëve nga radioja dhe televizioni. E diplomuar për gazetari ajo e ushtroi për shumë vite këtë profesion, por publiku më shumë e njeh si "Ilda e Super Starit". Pasioni për muzikën ka bërë që gjithmonë të jetë në kontakt me të. Pas daljeve të shumta në "Top Fest", realizimit të klipëve të ndryshme, Ilda Mërkuri solli hitin "Super Star", që u shndërrua në një nga këngët më të dëgjua dhe të dashura të shqiptarëve. Asnjëherë nuk e shkëputi marrëdhënien me radion dhe televizionin ku ishte një nga gazetaret e para që i bëri pjesë të emisionit ndjekësit me anë të sms-ve. Vitet e fundit ajo pati një shkëputje, duke iu dedikuar familjes. Ilda sot është martuar dhe është shumë e lumtur pranë bashkëshortit. Por, nëse menduat se gazetaria hoqi dorë nga jeta publike, e keni gabim. Ditët e fundit, ajo është rikthyer më në formë se asnjëherë, me një baladë të ndërë, dedikuar dikujt që nuk jeton më. Mësojmë se Ilda ka humbur nipin në një aksident automobilistik dhe gjithë marrëdhënien me të e ka sjellë në këngën e lançuar së fundmi.

Si ka qenë rruga jote çdo mëngjes drejt studios së radios?

Rruga ime çdo mëngjes drejt radios ka qenë pa ndonjë gjë interesante, një



kafe në mëngjes dhe në radio.

Çfarë e bën Ildën të veçantë nga gazetaret e tjera?

Nga gazetaret e tjera të veçantë më bën thjeshtësia e tepërt. Unë jam një njeri me këmbë në tokë dhe qëllim kam pasur argëtimin e të tjerëve, jo t'ju çaja dërrasat me marketing për veten.

Ekspëriencat në "Top fest" sa kanë lënë gjurmë tek ty?

Ka lënë shumë gjurmë,

sepse ka qenë një eksperiencë shumë e bukur dhe ndër hapat e mia të para drejt muzikës. Më lidhi më shumë me publikun dhe me muzikën. Sigurisht, ishte shumë e mirë për kohën.

Projekti yt i fundit ka të bëjë me humbjen e një njeriu të shtrenjtë. Sa e vështirë ka qenë të këndoje për të?

Ka qenë shumë e vështirë të këndoje për një engjell që nuk e imagjinoja dot mos të ishte më mes nesh. Më shumë se e vësh-

tirë ka qenë e dhimbshme t'i këndosh dhimbjes. Janë një mori ndjenjash të përfshira bashkë, të cilat e bëjnë njeriun të mendojë se do të eksplodojë në moment. Por, ja që jo. Edhe dhimbja u kthyeka në art.

Mënyra më e mirë për të fshehur një dhimbje?

Mënyra më e mirë për të fshehur një dhimbje është të vazhdosh përpara dhe pse do të dhembë gjithnjë brenda vetes. Është mirë që edhe nga dhimbja të nxjerrësh diçka, të japësh një mesazh, të tregosh dikujt që nuk është vetëm, të bindësh të tjerët që janë gjëra të jetës. Dhimbja nuk fshihet, thjeshtë njeriu mësohet të jetoj me të.

Si ia bën me njerëzit "mbytës"?

Me njerëzit mbytës, fare e thjeshtë mendohej t'i mbaj sa më larg kur i kuptoj. Ndoshta i lë pak kohë që ti kuptoj pse janë të tillë. Ama jam aq e fortë sa mos t'i lë të kenë ndikim tek unë apo jeta ime. Kështu që larg tyre.

Gjëja që më tërheq më shumë të bashkëshorti?

Gjëja që më tërheq më shumë të bashkëshorti, hmmm nuk veçoj dot asgjë sepse është perfekt ndaj është bashkëshorti im. Nuk



kursehem kurrë për të treguar sa i mirë është dhe sa femër me fat jam. Ai është pjesa ime plotësuese, mendimi i parë dhe i fundit, gjithçka e bukur që kam. Ndaj të gjitha gjërat më tërheqin tek ai.

Për çfarë nuk kursehesh kurrë?

Mund të kursehem ndaj kritikave për dikë që të mos e lëndo. Për sa i përket gjërave materiale nuk kursehem aspak, jam shumë dorëlëshuar dhe besoj se kjo gjë ka të bëjë me llojin e njeriut që je. Unë jam shumë bujare dhe zemërmirë ndaj nuk do të kurseja asgjë për askënd. Nëse mund të bëj diçka pse jo, do e bëja me shumë kënaqësi.

Cila ngjyrë e dominon tablonë e jetës tënde?

Tablonë e jetës sime e dominon e bardha. Unë mendohej të kem pranë vetes njerëz të mirë, të përjetoj situata të mira. Të jem e qetë. Prandaj them që është e bardha, sepse simbolizon paqe, mirësi, lumturi dhe janë gjendja ime shpirtërore.

Përveç muzikës, ku do e shohim Ildën?


Një gjë është e sigurt, që nuk do të mungoj më kaq shumë se ma kanë bërë vërejtje këtë gjë. Veç projekteve muzikore kam edhe disa projekte të tjera që mentalisht nuk po i bëj publike, por do t'ia lë kohës. Për sa i përket gazetarisë, mbetet për tu parë në vazhdim nëse do t'i rikthehem përsëri televizionit apo jo. Shumë shpejt do të ketë të reja.



I nxori të gjitha! Albërie Hadërgjonaj poston foto provokuese nga shtrati

Albërie Hadërgjonaj njihet për pamjen e saj të mahnitshme dhe jo rrallëherë tregon se ndihet krenare për format e saj me anë të fotografive dhe videove të ndryshme. Megjithatë, këtë herë këngëtarja duket se ka kaluar limitet me një postim që ka bërë së fundmi. Ajo shihet e zjarrtë e veshur në të brendshme provokuese me ngjyrë të kuqe, ndërsa shumë pak i ka fshehur pjesët intime. Aktualisht Hadërgjonaj jeton në Amerikë, ku jo rrallë herë është e pranishme në koncerte ku ka shqiptar.

Ajo shumë shpesh përfillet edhe për format trupore. Krahas moshës Albëria u bën konkurrencë vajzave të reja me paraqitjet publike.



Më e nxehtë se kurrë, Flaka 'i dogji' të gjithë me imazhet e fundit

Ajo ka qenë Agjithmonë për thyerjen e tabuve sidomos në veshje. Flaka Krelani është një nga këngëtarët më të dashura për publikun. Bukuroshja është mjaft aktive në rrjetet sociale, ku së fundmi ka postuar një fotografi tejet provokuese. E veshur me të brendshme të zeza Flaka duket shumë seksi. Bien në sy këmbët e saj dhe trupi në super formë, për të cilin ajo sigurisht që po punon shumë. Flaka nuk njihet në këtë fotosesion të realizuar. Ndoshta bukuroshja po paralajmëron një projekt të ri megjithatë për të konfirmuar këtë aludim duhet të presim.




Nuk e prisnim! Kejvina thotë troç kush mund ta zëvendësojë te "Xingu"

Në puntatën e kësaj të shtunë në "Xing me Ermalin", velina Kejvina Kthella njoftoi publikun se do të largohet nga emisioni në mes të sezonit, pasi diçka e bukur po e priste në Itali. Ermal Mamaqi gjatë emisionit ka bërë në këtë mënyrë edhe thirrjen për të gjitha vajzat që janë të bukura dhe të talentuara të aplikojnë për të zëvendësuar Kejvinën. Pas largimit nga emisioni, Kejvina Kthella ka thubuar në 'Instastory' velinën e re që do t'i zërë vendin në "Xing me Ermalin". Ajo ka deklaruar se përveç specit të kuq me të cilin ka pozuar në foton e publikuar, askush tjetër nuk mund ta zëvendësojë në emision. "Vetëm ky speci i kuq më zëvendëson mua tek "Xingu"- ka shkruar Kejvina.



"Nuk i ndihmova dot", ja reagimi i Taynës për atë që ndodhi në koncert

Gjatë koncertit të reperes shqiptare Tayna me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas pati disa incidente. Për shkak se salla ishte e tejmbushur, disa prej fansave nuk janë ndjerë mirë dhe u ka rënë të fikët nga mungesa e ajrit. Vetë reperja ka shprehur keqardhjen për këtë situatë dhe faktin që nuk mundi t'i ndihmojë fansat e saj, ndërsa u uron atyre të kenë shëndet. Në një postim në 'Instagram' ajo ka shprehur keqardhjen për këtë situatë që e bëri të ndalonte performancën deri sa të sigurohej që fansat ishin mirë. Këngëtarja është duke shijuar suksesin e hiteve të saj duke performuar në koncerte dhe në clube të ndryshme.



Opozita s'i bashkohet Listës Serbe për rrëzimin e Haradinajt

Avdullah Hoti: Nuk pranojmë kushte nga askush, do procedojmë me mocion të votëbesimit

Partitë opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Socialdemokrate kanë deklaruar se nuk do të bashkëpunojnë me Listën Serbe për rrëzimin e qeverisë Haradinaj. Shefi i grupit parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, është shprehur se partia e tij do të procedojë në Kuvend mocionin e votëbesimit ndaj qeverisë Haradinaj, në momentin që i siguron 61 vota, për rrëzimin e qeverisë, por sipas tij nuk do të pranojnë kushtëzime nga askush. "LDK do të procedojë me mocion të votëbesimit ndaj, në momentin që sigurohen 61 vota në Kuvendin e Kosovës. Por, nuk pranon asnjë kushtëzim nga askush", ka thënë Hoti, përmes një postimi në "Facebook". Deputeti i Vetëv-



AVDULLAH HOTI
"LDK do të procedojë me mocion të votëbesimit ndaj qeverisë së PAN-it në momentin që sigurohen 61 vota në Kuvendin e Kosovës. Por, nuk pranon asnjë kushtëzim nga askush", - ka thënë Hoti, përmes një postimi në "Facebook".

endosjes, Rexhep Selimi ka deklaruar se pavarësisht se qeveria Haradinaj u formua me bekimin e qeverisë së Serbisë, si parti nuk pranojnë rrëzimin përmes Listës Ser-

be. "Pavarësisht se qeveria u formua me Listën Serbe, respektivisht me bekimin e qeverisë së Serbisë, ne nuk e rrëzojmë qeverinë përmes kësaj partie, por përmes

sa më parë, por jo sepse do Serbia, por sepse duan qytetarët e Kosovës." -ka thënë Selimi. Sipas tij ndonëse Vetëvendosje nuk mbështetet në vullnetin e Listës Serbe, nëse këta të fundit vendosin të votojnë pro rrëzimit të qeverisë, atëherë partia e tij nuk mund t'ua ndalojë një gjë të tillë. Shefi i Grupit Parlamentar të PSD-së, Dardan Sejdiu, ka thënë se partia e tij nuk ka vota për të bashkëpunuar me Listën Serbe në Kuvendin e Kosovës. "Nuk kemi vota për ata që i quajnë bandita përfaqësuesit legjitim të Kosovës dhe për ata që veprojnë çdo ditë kundër Republikës së Kosovës. Mbetemi jo vetëm të hapur, por edhe të interesuar për bashkëpunim me të gjitha forcat progresive lokale dhe rajonale që angazhohen për barazi midis popujve", ka thënë mes tjerash Sejdiu.

Tragjike në Gjermani, përplasen për vdekje dy motrat shqiptare

Dy vajza shqiptare nga Kosova kanë humbur jetën ditën e të dielës në një aksident rrugor në Gjermani. Sipas mediave gjermane, personat që humbën jetën në këtë aksident janë motra, të martuara ku bashkëshortët i kanë vëllezër; me iniciale H.Sh dhe F.Sh. Viktimat janë me origjinë nga Gjakova. Në raportimin e mediave gjermane theksohet se përveç viktimave, të lënduar nga ky aksident mbetën edhe katër persona të tjerë. Në aksidentin tragjik u përfshinë dy makina tip Mercedes dhe Opel dhe përplasja e tyre rezultoi fatale për dy motrat shqiptare. Ndërkohë raportohet se është në gjendje të rëndë shoferi i makinës tip "Opel", i cili po lufton për jetën si pasojë e plagëve të marra.

Ramush Haradinaj: Gjermania është partner i rëndësishëm i Kosovës

Delegati i BE: Brukseli i angazhuar të arrihet marrëveshja Kosovë-Serbi

Eksperti amerikan: Thaçi është mashtruar nga Vuçiç e Putin

Sam Fabrici, kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Serbi, ka thënë se Brukseli është i angazhuar për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Fabrici ka përsëritur se Brukseli është i angazhuar për të arritur një marrëveshje që do të jetë ligjrisht detyruese, e cila ka për synim normalizimin e plotë të marrëdhënieve. Siç shkruan televizioni shtetëror serb, Fabrici, duke mos dashur ta komentojë deklaratën e fundit të nënsekretarit të Shtetit Amerikan për Çështjet Politike David Hale, i cili tha se "qëndrimi i SHBA është një njohje e pranueshme reciprokisht e Kosovës dhe Serbisë", por Fabrici ka thënë se edhe qëndrimi i BE-së për njohjen e Kosovës është i qartë. "Ju e dini qëndrimin e Bashkimit Evropian për njohjen e Kosovës, është e qartë. Ne jemi në favor të arritjes së një marrëveshjeje që do të jetë ligjrisht e detyrueshme, me normalizimin e plotë të marrëdhënieve", deklaroi Fabrici. Shefi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Serbi nuk ka dashur të komentojë pikëpamjet e partive të tjera apo rezultatit e mundshëm të dialogut. Ndryshe Hale gjatë qëndrimit të tij në Prishtinë deklaroi se, Kosova është përpara hapit kyç në rrugën drejt një të ardhmeje të begatë. Sipas tij, për t'u arritur kjo gjë, duhet marrëveshja gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë, në të cilën pika kyçe është njohja e qëndrueshme në mes të dyja shteteve. Ndërkaq dje kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim këshilltarët për politikë të jashtme të Kancelares Gjermane, Angela Merkel, Jan Hecker dhe Matthias Lüttenberg, me të cilët ka biseduar rreth zhvillimeve politike dhe ekonomike në vend



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj në takim me këshilltarët të politikës së jashtme të kancelares Gjermane, Angela Merkel

dhe rajon, si dhe normalizimin e dialogut me Serbinë. Mësohet se gjatë takimit, kryeministri Haradinaj është shprehur se Gjermania është një nga partnerët më strategjikë të Kosovës. "Gjermania është një nga partnerët politik dhe ekonomik të Kosovës, e cila i ka dhënë mbështetje në momente të vështira dhe tani në fuqizimin e zhvillimit ekonomik dhe ofrimin në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar. Për këtë u jemi mirënjohës", është shprehur kryeministri Haradinaj. Ndërkaq, eksperti amerikan i politikës së jashtme David Phillips, ka deklaruar se Rusia e kundërshton çdo marrëveshje me Kosovën dhe Serbisë, me përjashtim, siç thotë ai, të një ujdie që do ta transformonte Kosovën në

një shtet të cinguar nëpërmjet përshtatjeve kufitare të konceptuara keq. Phillips, ka deklaruar se presidenti Thaçi është mashtruar nga Vuçiç dhe Putin duke menduar se rregullimi i kufirit është një opsion i mundshëm. Pretendimet se Rusia do ta përkrahte një marrëveshje eventuale mes Kosovës dhe Serbisë në kuadër të fazës finale të dialogut, e cila do t'i siguronte vendit njohje nga fqinji verior dhe një ulëse në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), i kundërshton eksperti amerikan i politikës së jashtme, shkruan sot gazeta "Zëri". David L. Phillips, i cili ka qenë këshilltar i lartë në Departamentin Amerikan të Shtetit, ka deklaruar për "Zërin" se Rusia e kundërshton çdo marrëveshje ndërmjet Kos-

ovës dhe Serbisë, me përjashtim, siç thotë ai, të një marrëveshjeje që do ta transformonte Kosovën në një shtet të cinguar nëpërmjet përshtatjeve kufitare të konceptuara keq. Ai ka shtuar se mbështetja e idesë për ndarje të Kosovës, gjithashtu, i përshtatet qëllimit strategjik më të gjerë të Rusisë, pasi që, siç thotë Phillips, do t'i nxiste përçarjet në shoqërimin kosovare që mund të rezultojë në dhunë, duke diskredituar kështu projektin e Kosovës. "Presidenti Thaçi është mashtruar nga Vuçiç dhe Putin duke menduar se rregullimi i kufirit është një opsion i mundshëm. Kjo nuk është zgjidhje. Rregullimi i kufirit do ta dobësojë Kosovën dhe do të krijojë ndarje në shoqërimin kosovare", shprehet Phillips.

RAMUSH HARADINAJ

"Gjermania është një nga partnerët politikë dhe ekonomikë të Kosovës, e cila i ka dhënë mbështetje në momente të vështira dhe tani në fuqizimin e zhvillimit ekonomik dhe ofrimin në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar. Për këtë u jemi mirënjohës", ka thënë Haradinaj.

Ambasadori britanik apel qeverisë kosovare: Qëndroni larg drejtësisë

Ruairi O'Connell, ambasadori i Britanisë së Madhe, në një tryezë të organizuar nga IKD është shprehur se mungesa e rezultateve, pandëshkueshmëria, mos reagimet mbeten problem kyç në luftimin e korrupsionit në Kosovë. Sipas tij, këto janë pasojat e përfshirjes së politikës në sistemin e drejtësisë. "Ne vazhdojmë të kërkojmë prej politikës që mos të ndikojë në sistemin e drejtësisë, duke u përfshirë në emërimin e prokurorëve dhe gjykatësve, kryeprokurorëve, kryetarëve të gjykatave. Duhet lënë të pavarur, se vetëm në këtë mënyrë do të ketë rezultate, do të luftohet kriminaliteti dhe do të ketë drejtësi për qytetarët", është shprehur O'Connell. Ambasadori Britanik theksoi se kërkesa e tyre është shumë e qartë, se Kosova nuk mund të jetë strehimore e korrupsionit dhe krimin të organizuar, por që sipas tij, po vazhdohet të dëshmohet e kundërta. "Deri kur mund të vazhdojë Kosova të ketë përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, kur vazhdon të dëshmojë mungesën e luftimit të krimin të organizuar dhe korrupsionit. Është koha e fundit që zyrtarët me integritet të kontestuar të ecin nga pozitat dhe të ndiqen për veprimet e tyre", ka thënë ai. Sipas O'Connell, prokurorët dhe gjykatarët mund dhe duhet të bëhen heronj të rinj të Kosovës.



"Shans për të jetuar", dy pasagjerët që i shpëtuan përplasjes së avionit

Tragjedia e së dielës, Etiopia dhe Kina pezullojnë "Boeing 737"

Kina: Stop përdorimit të Boeing 737 Max

Pas tragjedisë ajrore të dielës në Etiopi, ku humbën jetën 157 persona autoritetet etiopiane, por edhe ato në Kinë u detyruan të pezullojnë fluturimet e avionëve të modelit të rënë. Bëhet fjalë për këtë model avioni 'Boeing' 737 të tipit Max 8. Avioni i rënë pranë kryeqytetit etiopian Adis Abeba është aksidenti i dytë tragjik në 5 muaj, pas atij të të njëjtit model të Lion Air në Xhakarta të Indonezisë, tetorin e vitit të kaluar, ku humbën jetën 189 persona. Hetuesit në Etiopi ende nuk kanë një variant zyrtar mbi shkaqet e tragjedisë së të dielës. Por njëllor si në rastin e Indonezisë edhe avioni Boeing i Ethiopian Airlines ra pak minuta pas ngritjes. Të dy ishin të sapa prodhuar. Nuk përjashtohet mundësia që avionët të jenë prodhuar me defekt në sistemin e drejtimit automatik, që mund t'i ketë përcjellë pilotit të dhëna të gabuara, duke e alarmuar atë për shpejtësi më të madhe ose lartësi mbi atë që ka qenë në realitet. Me të tillë avionë operojnë edhe 40 kompani në të gjithë botën, përfshirë edhe vendet perëndimore. Por deri më tani, vetëm Etiopia dhe Kina kanë pezulluar fluturimet e tyre dhe po hetojnë për këtë rast. Kompanitë ajrore kinëze kanë marrë urdhër për të hequr përdorimin e 'Boeing 737 Max' pas aksidentit të së dielës. Lajmin e bën të ditur revista financiare Caizjing, e cila citon burime pranë Civil Aviation Administration of China. Aksidenti i të dielës është i dyti për një 'Boeing 737 Max 8'. Avionin Civil kinez, konfirmon që vendimi është marrë pas konsultimeve me agjencitë homologe amerikane dhe 'Boeing'. Në pritje për të njohur motivet e përplasjes së djeshme ajrore ku vdiqën 157 vetë edhe Ethiopian Airlines ka njoftuar se ka



bllokuar të gjithë avionët Boeing 737-8 Max. Në një komunikatë publike në Twitter, Ethiopian Airlines ka vendosur të mos ngrëjë më në ajër asnjë 'Boeing 737-max'. Nga ana tjetër, të paktën dy pasagjerëve besohet se i është dhënë një mundësi e dytë për të jetuar, pak pasi humbën fluturimin fatal të 'Ethiopian Airlines', ku të gjithë pasagjerët përfshirë dhe ekuipazhin humbën jetën menjëherë pas rëzimit. Vetëm dy minuta mund të ndryshojnë fatin e dikujt, dhe këtë gjë e zbuloi fare mirë Antonis Mavropoulos, i cili humbi fluturimin fatal vetëm se mbërriti vonë në aeroport. 'Isha i nevrikor që nuk më lanë të futesha brenda në avion', tha ai për televizionin grek, ALPHA TV, duke kujtuar sesi

zemërimi i tij u shua, pasi zbuloi se 'Boeing 737 MAX' ishte përplasur, pak minuta pas fluturimit. Pas lajmit shokues, greku arriti në përfundimin që ajo ditë, ishte dita e tij më me fat. "Jam mirënjohës që jetoj dhe që kam shumë miq që më bëjnë të ndiej dashurinë e tyre", ishin fjalët që ai ndau në 'Facebook'. Por, Mavropoulos nuk ishte i vetmi pasagjer që kishte të dielën, ditën me fat. Ahmed Khalid, gjithashtu, humbi fluturimin drejt Nairobi. Kujtojmë se në tragjedinë e të dielës avioni ra rreth 60 kilometra në juglindje të Addis Ababas, rreth orës 8.44 të mëngjesit, vetëm 6 minuta pasi ishte ngritur nga aeroporti i kryeqytetit etiopian me destinacion Nairobi në Kenia. Shkaqet e tragjedisë janë

ende të paqarta. Autoritetet etiopiane thanë se piloti kishte kërkuar leje për t'u rikthyer në aeroportin nga ku ishte nisur vetëm pak sekonda para zhdrukjes nga radarët. Dëshmitarët në vendngjarje thanë se kishin parë flakë që dilnin në njërin nga krahët e avionit. Në bordin e avionit, shumica e

pasagjerëve ishin kenianë, por kishte edhe kanadezë, italianë, amerikanë, britanikë e francezë. "Ethiopian Airlines" konsiderohet një linjë e sigurt edhe pse avionët e saj janë përfshirë në dy aksidente tragjike të tjerë në 3 dekadat e fundit, në 2010-ën dhe në 1996, me 213 viktima në total.



Një grua u sulmua nga një jaguar në kopshtin zoologjik të Feniksit në Arizona, pasi ajo kapërcëu rrethojnë për të bërë një fotografi, "selfie" me kafshën e egër. Incidenti ndodhi të premtën, me 9 mars dhe vizitorja pritet të ketë një shërim të plotë nga plagët e marra. Gruaja u kthye në kopshtin zoologjik të kafshëve të egra në Litchfield Park pas sulmit dhe tha se ajo "ndihet shumë keq për publicitetin negativ që kopshti zoologjik po merr pas incidentit".

SHKURT

Alarmon UNICEF:
Mbi 1 mijë fëmijë të vrarë në Siri

Në Siri, vetëm në vitin 2018, mbi 1 mijë fëmijë kanë mbetur të vrarë gjatë luftimeve. Numri i fëmijëve të vrarë është numri më i lartë që nga fillimi i luftës, në vitin 2011. "Këto janë vetëm shifrat që OKB, ka qenë në gjendje t'i verifikojë, por shifrat reale me shumë siguri janë disa herë më të larta", bën me dije drejtori i UNICEF, Henrietta Fore. UNICEF kërkon nga shtetet anëtare që të marrin përgjegjësinë për fëmijët në territorin e tyre.

Koreja e Veriut, Kim Jong-un fiton zgjedhjet me 100% të votave

Koreja e Veriut ka zgjedhur parlamentin e ri. Partia e Punëtorëve fitoi 100 për qind të votave duke rikonfirmuar liderin suprem Kim Jong-un në krye të vendit. Komiteti Qendror i Zgjedhjeve të Koresë njoftoi se 92.3% e njerëzve me të drejtë vote kanë marrë pjesë në zgjedhjet e djeshme. Zgjedhjet e 10 marsit janë të dytat, që nga ardhja në pushtet e Kim Jong-un, ndërsa ajo që vihet re është se ka një zbritje të votuesve koreano-veriorë në zgjedhje në krahasim me 5 vite më parë. Pesë vite më parë morën pjesë 99.97 për qind e tyre në zgjedhje. "Vendi ynë është i vetmi që feston zgjedhjet si të ishte një festë", thanë dje një pjesë e votuesve, të cilët u shprehën se me Kim Jong-un, Koreja e Veriut do të ecë përpara.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

Post Title: Senior Monitoring and Evaluating Expert
Duty station: Tirana (with 8 days in field missions in the municipalities of Shkoder, Mirdite, Vore, Cerrik, Pogradec, Berat, Rrogozhine), ALBANIA

Duration of Assignment: 25 working days during April - May, with 8 days field missions
Type of Contract: Individual Contract

Educational Background: Advanced University Degree in Economics, Public Administration, Political or a Development related field;

Work Experience: At least 10 years of experience in program design, monitoring and evaluation; Experience in conducting evaluations from a governance based perspective and thematic/sector evaluations. Familiarity with local governance developments in Albanian and related local government project evaluation experience is highly preferable

Demonstrated understanding of Albania's local governance system.
Experience in integrated governance programming / institutional development.

Tentative Starting Date: 01 March 2019
Deadline for Application: 19/02/2019
Job Description: Available at UNDP site:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

Post Title: Monitoring and Evaluating Expert

Duty station: Tirana (with 8 days in field missions in the municipalities of Shkoder, Mirdite, Vore, Cerrik, Pogradec, Berat, Rrogozhine), ALBANIA

Duration of Assignment: 25 working days during April - May, with 8 days field missions
Type of Contract: Individual Contract

Educational Background: University Degree in Economics, Public Administration, Political or a Development related field;

Work Experience: At least 5 years of experience in program design, monitoring and evaluation; Experience in conducting evaluations from a governance based perspective and thematic/sector evaluations. Familiarity with local governance developments in Albanian and related local government project evaluation experience is highly preferable. Excellent knowledge of both written and spoken English.

Demonstrated understanding of Albania's local governance system.
Experience in integrated governance programming / institutional development.

Tentative Starting Date: 01 March 2019
Deadline for Application: 19/02/2019
Job Description: Available at UNDP site:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

EKSPOZITA

Ndryshimet e Tiranës në 30 vite, në sytë e një italiani

Fatmira Nikolli

Kujtesa e një slogani në formën e instalacionit më germa të mëdha dhe inkandeshente nga grupi Superflex: NE JEMI NË TË NJËJTËN VARKË", më erdhi në mendje për të hedhur dritë mbi eksperiencën artistike të artistit italian Eugenio Tibaldi nëpërmjet workshop-it me studentët (Fakulteti i Arteve të Bukura - Universiteti i Arteve, Tiranë), si pjesë procesuale e komunikimit dhe diversitetit të dialogut kulturor thotë Prof. Asc. Ardian Isufi, dekan - Fakulteti i Arteve të Bukura

Shton se Supreflex shpesh herë fton publikun të jetë pjesëmarrës në projektet e tij duke zhvilluar dhe analizuar modele eksperimentale të shumë çështjeve dhe fenomeneve globale për të gjetur zgjidhje të fenomeneve social-shoqërore dhe vepra e artit e sipërpërmendur është një sentencë si "thirrje" për degjese publike mbi kushtet e përbashkëta humane duke iu referuar situatave të vështira që ka kapluar mbarë botën dhe më pas thirrja vepron si "eko" për t'na kujtuar se së bashku duhet të ndajmë përgjegjësitë për të njëjtat çështje dhe të njëjtat vështirësi. "Mendoj se E. Tibaldi ecën nën të njëjtën platformë artistike ku padyshim ka edhe nuanca të tjera, duke e orientuar dialogun me studentët - artistët e rinj mbi territore eksploruese që ata i kanë shkelur jo vetëm si evidentim i eksperiencës njerëzore, por si akumulim i reflektimit radikal të tyre nëpërmjet një sprove artistike. Ekspozita e realizuar në Galeria FAB shfaq qartësisht antikonformizmin e artistit dhe këtij aktivizmi artistik që "kolazhon kohë dhe ngjarje" sidomos nëpërmjet artefakt-ëve, në përpjekje për të ndërtuar struktura alternative të mendimit në funksion të orientimeve se si duhen analizuar fenomene të caktuara në mënyra të reja pamore", vëren Isufi.

Artisti italian Eugenio Tibaldi që prej muajit korrik 2018 e deri në mars 2019 ka ideuar një projekt që do të ekspozohet në Galerinë FAB të Universitetit të Arteve në Tiranë nga 11 deri më 31 mars 2019. Titulli i referohet një epoke historike shumë të saktë dhe sugjeron të tentohet të festohet, por për ta bërë këtë, në nuk duhet të jemi vetëm. Dhe pikërisht për këtë arsye artisti ka vendosur të realizojë projektin përmes një metode laboratorike.

Duke filluar nga ndarja e metodologjisë së saj dhe duke

Ekspozitë dhe përballje mes një artisti italian dhe artistëve të rinj shqiptarë



propozuar një temë të përbashkët për të punuar, veprat në ekspozitë janë rezultat i bashkëpunimit ndërmjet artistëve të rinj shqiptarë të cilët iu përgjigjën open call. Duke filluar nga vizita e parë e Tibaldit në Shqipëri në tetor të vitit 2018 dhe me rastin e Ditës Bashkëkohore, pjesëmarrësit në projekt kanë ecur, fotografuar, biseduar, analizuar, organizuar dhe prodhuar vepra nga të cilat del reflektimi i tridhjetë viteve të ndryshimit të qytetit të Tiranës nga 1989 deri më sot.

EKSPOZITA

Ekspozita "30YEARSOLD", ideuar nga artisti italian Eugenio Tibaldi, është hapur mbrëmje në orën 18:00, në galerinë FAB, Tiranë dhe do të qëndrojë e hapur deri më 25 mars 2019. I gjithë projekti nis me një thirrje të hapur për artistë nga të gjitha fushat e artit. Përzgjedhja e artistëve pjesëmarrës u bë prej vetë artistit, i cili ndau me ta



përvojën e tij profesionale, duke i dhënë rëndësi ecurisë së krijimit të një veprimtarie përbashkuese, për të arritur në përfundimin e rëndësishëm: bashkëpunimin mes artistëve dhe institucioneve, për ta kthyer hapësirën publike në një vend ku secili nga ne mund të krijojë përshpënyje e vet kritike për këto vite ndryshimi.

Ekspozita vjen kryesisht si rrjedhojë e përballjes dhe "dialogut" midis Eugenio Tibaldit dhe hapësirës publike në Tiranë, duke u ballafaquar me ndryshimet dhe shndërrimet e qytetit të Tiranës para dhe pas viteve '90. Veprimtaria nisi me endjen nëpër hapësira të caktuara të qytetit - aty ku rrugicat e vogla dhe shtëpitë me qerpic, tashmë gati-gati të harruara, janë zëvendësuar me ndërtesa shumëkatëshe - në kërkim të gjurmëve estetike që janë në gjendje të tregojnë ndryshimin dhe zhvillimin e tij në kohë. Kra-



hasimi i ngjarjeve dhe gjetjeve të formave që qyteti ka krijuar; ishin frymëzimi për krijimin e veprave të secilit prej artistëve pjesëmarrës. Skicat, pamjet, videot, idetë krijuese po shëndërohen ngadalë nga punë vetjake në tërësinë e një krijimi që do të përfaqësojë qytetin e Tiranës.

Kjo përvojë vlen jo vetëm për bashkëpunimin disamujor, por edhe për mënyrën se si ajo përmbillet. Veprimtaria dallohet më së shumti për tiparin edukativ të saj: drejtimin e një grupi artistësh të rinj në të gjithë hapat, që prej vëzhgimit të hapësirës publike, përfundimit të ideve krijuese deri në përmblyllje të një ekspozite të përbashkët. Lëvrimi i fushës artistike në këtë mënyrë bashkëvepruese, synon ta bëjë artin bashkëkohor të dukshëm dhe të rëndësishëm për t'u ndarë me shoqërinë dhe hapësirën publike.


Projekti u ideua nga artisti Eugenio Tibaldi dhe u mundësua nga Harabel Contemporary Art në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës dhe Universitetin e Arteve.

Eugenio Tibaldi, artist i tërhequr përherë nga ngjarjet

në zonat dytësore. I lindur në Alba CN, në vitin 2000 zhvendoset në zonën e thellë napoletane ku fillon një punë hulumtuese mbi lëvizimin informale, si dhe skicon një hartë të informilitetit. Në këto vite ka punuar rreth qyteteve të: Stambollit, Kajros, Romës, Selanikut, Berlinit, Veronës, Bukureshtit, Torinos, Karakasit dhe Brukselit.

Ndër ekspozitat e tij përmenden: "Fondazione Sandretto Re Rebaudengo", Torino (2007); "Manifesta 7", Bolzano (2008); "International Centre of Contemporary Art", Bucarest (Bukuresht) (2009); "Museo Madre", Napoli (2010); "Thessaloniki Biennale of Contemporary Art" (2013); "XII Biennale de L'Avana" (2015); "Museo Ettore Fico", Torino (2016); "Sala TAC/La Caja", Caracas (Karakas) (2017); "Museum MCDA Manila" (2017); "IIC" Neë York (Nju-Jork) (2017). Ka ndjekur: CSAV, fondacionin "Antonio Ratti", Como, Domus Academy ad Istanbul dhe ka qenë "Affiliate Felloë" pranë "American Academy" në Romë. Veprat e tij janë paraqitur në institucione publike dhe private në Itali dhe jashtë saj.

FESTIVALI



EUROSONG

Vrapi i ikjes, klipi i këngës së Jonida Maliqit, uji, zjarri dhe foleja

Fatmira Nikollë

Dy fëmijë të trembur vrapojnë mes ujit, zjarrit dhe shiut, duke lënë pas djerrinë dhe rrënoja. Një vrap për t'i ikur frikës, duke kthyer herë pas herë kokën pas, por duke kërkuar shpëtim. Lexon në hapat që hidhen me nxitim ankthin të ikurve në mesnatë pa parë se ku po i hedhin këmbët. Derisa një shi i madh, duke se lan gjithë baltën që e shkelëm kur ecnim në errësirë. Të gjuhëzuar që mezi ngrihen në këmbë, trupa që shquhen po nuk shihen. E kanë lënë folenë si në legjendën e shqiponjës.

"Është kjo foleja e një shqiponje, por që me këtë simbolikë autorët duan ta përgjithësojnë atë me folenë, apo shtëpinë e gjithkujt. Dhe foleja e çdo shqiptari, është Shqipëria. Kur folenë e prishin, e djegin dhe kur gjendesh mes flakësh, t'i mundohesh të gjeshe shpëtim, e shpëtimi është ikja. Ti ikën, por gjithçka mbetet aty: zanafilla, gjaku, origjina, identiteti e çdo gjë tjetër që të personifikon. Ti ikën, por brenda vetes lufton me dëshirën dhe klithmën e kthimit... Ktheju tokës tënde!", thotë kompozitorja Eriona Rushiti.

Kjo është ideja që përcjell videoklipin e këngës së Jonida Maliqit, "Ktheju tokës", me të cilën përfaqësohet Shqipëria në Eurosong.

Me muzikë dhe tekst të Eriona Rushitit dhe aranzhim muzikor të Enis Mullaj, ky klip vjen i realizuar nga Triangle Studios. Regjisori Genc Gjineci dhe Andi Kotri e kanë ngritur idenë e klipit mbi simbolin e folesë, sepse mesazhi i këngës vjen i përcjellë



Imazhet e videoklipit të këngës "Ktheju tokës", mesazhet e përbotshme

nëpërmjet folesë së shqiponjës, ujit dhe zjarrit! Fustani që vesh Maliqi është i stilistit Ardi Aslani dhe ruan të njëjtën ide që ka klipi: tokën, folenë dhe vendin amë.

Ideja e klipit ilustron idenë e tekstit "Ti këndon edhe qan/, në duar lotët mbledh, i mban.../ Një ditë jeton/, në tjetrën vdes/, sa mall, pak shpresë/I vetëm, pa identitet" dhe refreni "Ktheju tokës tende/ O njeri që zemrën lë peng/ Ktheju tokës tende/Ti e di një zemër të pret"- ndaj uji, zjarrit dhe toka, një fole e madhe që simbolizon.

Klipi i këngës përfaqësohet të Shqipërisë në Eurosong është publikuar ndërsa kënga interpretohet në gjuhën shqipe si në klip edhe në skenën e Eurovisionit, në Tel Aviv të Izraelit.

Vetëm disa orë pas publikimit, kënga shqiptare në Eurovision 2019, është pritur me komente pozitive të fansave evropianë, të cilët e kanë mirëpritur versionin final dhe videoklipin e këngës "Ktheju Tokës". Befasi të tjera

pritet të ketë në skenën e Eurovisionit në Tel Aviv, pasi grupi i "Ktheju Tokës", po punojnë për një prezantim mjaft të veçantë në netët live.

Prej ditës kur u shpall fituese e Festivalit të Këngës në Rtsh, vëmendja tashmë është drejtuar nga Maliqi. Këngës i janë bërë edhe covera. Kënga "Ktheju tokës" doli Fituese e Festivalit të 57-t të Këngës në Radio Televizionin Publik Shqiptar dhe konkurron në datë 16 maj në Eurovision 2019. Në javët në vijim nis nëpër Europë edhe turi promovues i këngës.

"Që kur e dëgjova për herë të parë nga ish-pedagogia ime Eriona Rushiti, ndjeva që kjo këngë ka shumë emocion brenda. Një emocion që nuk të lëshon, por rritet e rritet gradualisht. Që me dëgjimin e parë me çoi menjëherë në skenën e festivalit, pra dukej që nuk ishte një këngë për videoklip, apo këngë albumi, por një këngë që kërkonte një skenë të madhe për t'u dëgjuar. Dhe kur filluan provat në Sallën e Pallatit të Koncerteve, aty ndjeva se kjo këngë po merrte përmasat e një fitueseje, për sa i takon madhësitë që ajo ka", ka thënë Jonida.

Sa i takon pritshmëri për në Eurosong, në një intervistë ajo është shprehur se "Ne nuk jemi një shtet i madh, aq sa për të arritur të influencojmë në marrëdhëniet gjeopolitike. Por pjesëmarrjet tona atje kanë treguar se më një zë të fuqishëm, apo me një këngë të bukur nuk mbetesh pa u vlerësuar, apo pa lënë gjurmë. Është ende herët, pasi akoma nuk janë shpallur këngët pjesëmarrëse të Eurovision 2019. Ne jemi vendi i parë që e kemi shpallur dhe me aq sa kam parë, kënga është pritur mjaft mirë, si një këngë origjinale dhe autentike"



© Altin Çelmeta

Opinion i Ditës

Dështimi tragjik i shtetit

Nga Arben Idrizi

(vjon nga faqja 1)

... pothuajse. Me fjalë të tjera, është detyrë e shtetit ta "vrasë" nevojën që nga gjiri i tij të dalin shpëtimtarë të tjerë. Kur dështon ta arrijë këtë, atëherë, ndonjëherë për të mirë e ndoshta më shumë për të keq, nxjerrin kokën shpëtimtarët, (të vetë)shpallur shenjtorë a humanistë, sidomos ata të kampit religjioz.

Për mua është paksa edhe ironik ky dështim. Sepse, hiç më shumë se njëzet vjet më parë, vende nga e gjithë bota qenë ngrehur në këmbë të mishëroheshin me atë kujdes ndaj nevojtarit, pa asnjë interes, thjesht për të vënë drejtësi. Jo që ata nevojtarë të ndiheshin rehat në të qenit të ndihmuar, por që t'i merrnin këmbët dhe të ndërtonin një të ardhme në të cilën do të kujdeseshin për vetveten. Fatkeqësisht, Kosova u qeveris për tërë këto vite nga keqbërës të të gjitha animeve politike, kriminelë luftë e paqeje, skajshmërisht të pamëshirshëm në egon, papërgjegjës në ato arrogancën e tyre. Për rrjedhojë, tash dalin individë të caktuar ta luajnë rolin e shpëtimtarit.

Dështimi i shtetit është tragjik. Do të thotë se nuk ka mundur ta realizojë njërin prej kushteve parësore të veta, drejtësinë. Të pasurit e një strehe dhe mirëqenieje është një e drejtë. Schopenhaueri, te 'Fundamenti i moralit', thotë: "Drejtësia është virtyti i parë dhe fundamental themelor. Të gjithë filozofet e antikitetit e kanë njohur si të tillë, megjithatë i kanë koordinuar pranë tij tri virtyte të tjera... Mirëpo, nuk e kanë zgjedhur si virtyt dashurinë ndaj të afërmit, caritas-in, agapen (dashurinë vëllazërore). Edhe Platoni... e ka konsideruar si virtyt vetëm drejtësinë spontane dhe pa interes".

Dështimi i shtetit, më tej, pra është krim. Përfaqësuesit tanë politikë janë autorë të krimit, s'do mend. Por, nuk do të na ndihmojë asgjë të strukemi në strofullin e viktimit.

"Homo sum, humani nihil a me alienum puto". Me këto fjalë përmbledhet në latinisht gjeneza e nocionit 'humanitas'. I thotë një personazh i Terencit, te "Heautontimorumenos" (Ndëshkuesi i vetvetes). Pra, "Jam njeri, asgjë që ka të bëjë me njerëzit nuk është e huaj për mua".

Pavarësisht kësaj që u tha më sipër, është përherë e "palejueshme" të kesh qëndrim kritik ndaj atyre që (do të) marrin rolin e atij shpëtimtari, shenjtorit, humanistit. Nevojtarët janë të shumtë, përkrahësit dhe adhuruesit e verbër të tyre edhe më të shumtë dhe çdo dyshim ndaj të bëmave të tyre është i pafalshëm. Nevojtarët tashmë i kanë çuar du-



art nga kujdestari i tyre i vërtetë dhe më i sigurt, shteti, për të gjetur një lloj shpëtimi, kalimtar e ndoshta edhe të rremë, të shpëtimtari i vetëshpallur, individit. Në njëfarë mënyre, edhe vetë ty të bëhet se mos rastësisht po ngatërrohesh në një gjë ku sigurisht mund të kesh të drejtë, por po ashtu mund të shkaktosh, në mënyrë të pandreqshme, pa dashje, edhe dhimbje e mllëf.

Një shembull tipik i kësaj, kohës së fundit, është ai i Halil Kasttratit, të cilit adhuruesit nuk kursehen fare t'ia ngjeshin epitetin e humanistit. Në të vërtetë, të cilin nuk guxon ta kritikosh, sepse menjëherë një luzmë e paanë "ushtarësh" të rrjeteve sociale e më shumë se aq të hidhen në qafë. Të bëjnë copa-copa.

Po çfarë ka për t'u kritikuar në veprimet e tij?

Mbi të gjitha, maskimi i animit religjioz, bindjeve të tij personale, me aurën e humanitetit. Mund të jetë jo qëllimkeq, por është keqbërës. Për këtë është për t'u debatuar dhe për këtë është për t'u kritikuar. Dhembshuria nuk rrjedh nga besimi, por nga natyra jonë njerëzore. Ekziston përtej çdo besimi dhe çfarëdo ideologjie. Për këtë, çdo përpjekje për ta manifestuar besimin personal në aktivitetet të tilla është imponim dhe propagandim i besimit personal. Është sulm mbi bindjet dhe besim-

et e të tjerëve.

Një ilustrim për ta kuptuar më mirë Kasttratit është Labinot Tahiri. Ky zotëria, para se të përfundonte (aty ku synonte që në nisje) deputet i Kuvendit të Kosovës, merrej me veprimtari (të cilësuar prej vetë tij) humanitare. Duke i përcjellë të gjitha veprimet e veta me besimin e vet. Me ilahi e turbofolk. E hiç më larg se dje bëri një postim, në pak rreshta me plot gabime drejtshkrimore e mangësi kuptimore, në të cilin shfaqti, pa fije turpi, dy elemente të personalitetit të tij: hipokrizinë dhe racizmin. Hipokrizinë, sepse përmes rrjetit social i trumbeton botës se do t'ia japë një të riu në hall 500 euro nga rroga e vet, kur gjithë këtë (siç do të bënte një humanist) mund ta bënte në një mënyrë të fshehtë, pa rënë në sy dhe pa asnjë interes. Pse duhet ta marrin vesh të tjerët se do ta ndihmos dikë? Pse duhet të thuash publikisht se gjoja po e ndan rrogën tënde me dikë? Racizmin, sepse u kërkon të gjithë shqiptarëve t'i përqeshin njerëzit me ngjyrë, duke u referuar me terma ofendues, politikisht jo korrekt. Një deputet i Kuvendit të Kosovës, që e quan veten humanist (si Halil Kasttratit), manifeston racizmin e vet publikisht dhe i vetëkënaqur. Si mund të jetë humanist një njeri kaq i pashpirt dhe i pagdhundur?

T'i bëhet e vështirë apo e pamundur ta ruajë dinjitetin atij që është në vështirësi është sjellje e papranueshme. Edhe kur bëhet pa qëllim të keq. Një i skamur ka nevojë të përfitojë nga ndihma, bamirësia apo çkadoqoftë, por jo edhe në të njëjtën kohë t'i ekspozohet mbulimit medial, këmbimi i çfarëdoshëm, përveç nëse e kërkon vetë dhe gjithsesi nuk është në kundërshtim me ligjin. Në çdo rast tjetër, më do, është manipulim dhe përcimim i gjendjes së tij.

Edhe mjerimi është privatësi. Thelbi i humanitetit është pikërisht ky: ta ndihmojë atë që është në nevojë, pa bujë dhe pa vetëkënaqësi. Sidomos pa i përzirë në gjithë atë ndërmarrje bindjet politike, fetare, apo çfarëdo qoftë.

Manifestimi i bindjeve fetare duke e shndërruar të bëmën në një propagandim ideologjik është shkelje e të drejtave.

Po që se i sheh paraqitjet publike të Kasttratit, e vëren këtë tendencë; herë të dhënë haptas e herë me maskime të ndryshme. Pa dashur të rëndoj me ndonjë gjykim mbi ndjenjat e tij, përlojta nëpër video, duke i përdorur nevojtarët në to me qëllimin e fundit që ta mbivërë veten si një shpëtimtar, është manipulim i pafalshëm dhe hipokrizi e qartë.

Siç e thashë më lart, mbulimi

medial propagandistik i tillë më shumë se sensibilizim i të tjerëve është ekspozim egoistik i vetë të vetëquajturit humanist. Për ta imponuar veten, në emër të të tjerëve. Për më keq, në këtë shkullm errësire fetare, përmes ilahive.

Me gjasë, edhe ky, si bashkëfjetari i tij L. Tahiri, po e përdor fenë dhe mjerimin e njerëzve për të arritur deri te posti i deputetit, ose më shumë se aq. Me këtë, sigurisht, nuk është as më pak as më shumë i pamoralshëm e hipokrit se sa politikanët (ateistë) që e kanë përdorur nacionalizmin dhe mjerimin e qytetarëve për t'i arritur qëllimet e veta.

"Jam njeri, asgjë që ka të bëjë me njerëzit nuk është e huaj për mua". Kjo është formula e dhembshurisë si të tillë, jo e interesit, egos, manipulimit dhe hipokrizisë. Bashkëndjenja është virtyti human që ka ekzistuar para dhe përtej karitasit, mëshirës religjioze. Nuk do të kesh asnjë përfitim, kurdoqoftë. Qëllimi është t'ia lehtësosh tjetrit vuajtjen. I shtyrë jo nga frika e Zotit, shpërbllimi në botën e tashme a të përtejme, por nga të qenit njeri. E gjithë kjo thjesht zbulon natyrën tonë, të qenit njeri. Vetëm kaq.

Gazeta Express

Opinioni / Ditës

Boll i bëmë mirë qeverisë të na bëjë keq!

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...vesh ku. Por asnjëherë nuk u kap me presh në duar. Gjithnjë, sa herë ndodhte një vjedhje e re, në klub të fshatit shumë syresh e akuzonin fshatçe, me zë të lartë dhe përballë. Por nuk arrinin dot të faktonin vjedhjen. Prandaj dhe, me kalimin e kohës njerëzit në fshat nuk habiteshin më, madje nisën të mërzhiten me këto akuza. U qëllonte të bezdiseshin duke dëgjuar të njëjtin lakim emri, edhe pse vjedhjet nuk pushonin. Kur më në fund, një prej tyre e kapu hajdutin duke vjedhur në një nga kotecet e tij, me pulë në dorë dhe përhapu lajmin, askush nuk e besoi. Madje edhe shkuan dhe e zgjidhën hajdutin aty ku e mbante lidhur bashkëfshatari që e kapi, duke i dhënë mundësinë të largohej përgjithmonë nga fshati. Në qershor 2017, u zhvilluan zgjedhjet më të qeta të përgjithshme që kemi patur ndonjëherë. Në dy ditët e para, kur ende nuk dihej fituesi, nuk u kundërshtuan nga asnjë prej të treja palëve partiake në garë. Më vonë, nisi baleti i akuzave dhe kundërakuzave, kur u pa qartë kush ishte fituesi. Pastaj erdhi breshëri i akuzave për narko-shtetin dhe për lidhje të pazgjidshme me trafikantët e drogës dhe krimin. Dhe sa më shumë dendësohej ky breshër dhe i mbante njerëzit të mbërthyer pas ekraneve me këto pseudolajme(ishte ushqimi i përditshëm i yni gjatë periudhës tetor 2017-janar 2019, praktikisht fاندakjsja jonë), pa asgjë të faktuar realisht, aq më shumë merrnin zemër hajdutët e mirëfilltë brenda qeverisë. Pse çdo qeveri ka hajdutët e vet. I korruptuari më i rrezikshëm është ai që harrohet. Të mbrojtur nga përgëndrimi i vëmendjes vetëm në hartimet-demoncime të deputetëve në papjekur të dy partive kryesore në opozitë, lidhur me të pabërat aspak të provuara të kësaj qeverie për lidhjet me trafikun e lëndëve narkotike dhe me kriminelët që mbronin këtë trafik, këta hajdutë me çizme të qeverise menduan të vidhnin rehat përmes tenderëve. Dhe e realizuan me sukses! Ka shumë të drejtë një përfaqësues i Partisë Demokratike (sot ende deputet dhe i mohuar nga të vetët), kur shprehet se janë vetëm 13 kompani që kanë marrë tenderët më të rëndësishëm qeveritarë në këto dhjetë vitet e fundit(2009-2018). Dhe që opozita i quan oligarkë dhe bën gjoja luftë shtrigash sot me ta(me shumicën e tyre ka bërë flërt dhe është mbushur me para prej tyre, kur ka qenë në pushtet), për të kanalizuar revoltën e njerëzve. Mirëpo sot nuk kemi asnjë përfaqësues kompanish të huaja dhe me emër ndërtimi apo inves-



timesh më në tenderët tanë më të rëndësishëm shtetërore. Pra, në ekonominë tonë kombëtare. Sikurse ndodhte në vitet 2002-2008. Kjo është një humbje e madhe, e shkaktuar nga një politikë kriminale ekonomike. Mos vallë tregu shqiptar dhe paraja akoma dhe më e shtuar për investime e taksave të qytetarëve të këtij vendi nuk ishte më tërheqëse për kompanitë e huaja? Jo! E vërteta qëndron se ato thjesht kuptuan lojën e trukuara të tenderëve tona qeveritare dhe nuk pranuan më të humbinin kohën e tyre, duke garuar për objektive investimi që ishin të paracaktuara kush do t'i ndërtonte. Dhe kështu u dhanë gjatë viteve 2009-2018 koncesione(si dhe në katër vitet e fundit, edhe kontrata të partneritetit publik-privat) me vlerë deri 4.8 miliardë euro! Dhe i morën këto 13 kompani vendase që përmend përfaqësuesi i sotëm kurajoz i Partisë Demokratike, ende në Kuvend(edhe i vetëm trim në luftë). Në tetor 2018, nga një zbulim gazetaresk, i erdhi radha hajdutit të fshatit tonë Shqipëri të kapej me presh ndër duar. Ata që vendosnin për tenderët kryesorë në ndërtimin e rrugëve i thanë oligarkut të radhës "Boll, nuk t'i

gjapim më ty direkt këto 30 milionë euro tenderë, se ke marrë shumë dhe je bërë bozë! Shko gjej një kompani të huaj, mundësisht nga përtej oqeanit, në SHBA, se aty edhe nderohemi dhe bëjmë gjoja sikur po ia japim asaj, kur në fakt je prapë ti". Dhe kështu u veprua. Vetëm se oligarku, i bindur që shteti e kishte ndër duar(dhe e kish të vërtetë), nuk u lodh të gjente një kompani prej vërteti nga shteti Delaware(shteti i dytë më i vogël i SHBA-ve, i vetmi shtet parajsë fiskale e biznesit vendas), për ta bërë ortak, ose të paktën t'i paguante një shumë simbolike përfaqësimsi. Jo, oligarku thjesht e pa më të udhës ta "shpikte" atë. Kështu kishte më pak shpenzime. Pra, prodhoi letra false për një kompani po false. Dhe në pak ditë, kjo kompani fantazmë bëhet fituese e një gare tenderimi në Shqipëri me vlerë 20 milionë euro! Dhe më vonë fiton edhe 10 milionë euro të tjera nga një garë e dytë. Këtu hajduti me çizme u kap i lidhur tek gardhi i fshatarit. Këtu opozita e vendit kishte material boll ta bënte kauzë dhe të bindte shqiptarët se realisht i dhimbeshnin paratë e taksapaguesve të shpërdoruar dhe tallura në këtë

farë feje. Por jo. Opozita heshti. Heshiti pse oligarku i lidhur me kompaninë e huaj false kapur ishte mik për kokë i saj. Dhe ndërsa qeveria, nën presionin edhe të protestës së studentëve në dhjetor 2018, në ditët e para të janarit 2019 ndërronte më shumë se gjysmën e ministrave të saj, hajduti i kapur, i ndihmuar edhe nga heshitja e opozitës, u largua nga gardhi. Pushoi së qeni më i lidhur. Prandaj dhe me tërë këtë tallovi të sotme të pseudoakuzave për narkoshtet dhe lëvizjeve politike jashtë sistemit, nuk kemi bërë gjë tjetër vetëm se vijojmë t'i "bëjmë mirë" kësaj qeverie, t'ia besojmë të ardhmen e saj në pushtet, duke mos e mbajtur të përgjegjshme për shpërdorimin e parave të shqiptarëve. Dhe në këtë mënyrë, duke e lejuar të na bëjë keq. Beteja e sotme e opozitës, duke pritur pas 5 ditëve, më 16 mars protestën e madhe të radhës, është e pabukë për interesat tona reale si qytetarë. Kjo protestë nuk bëhet për hajdutin me çizme që u kap në tetor 2018. Jo. Bëhet thjesht pse opozita do pushtetin dhe rrit presionin mbi qeverinë për lëshime. Kurse ne si qytetarë duam mbrojtjen e parave tona.

HOROSKOPI

DASHI

Duhet të kërkoni pika të tjera referimi. Merrni parasysh se qëllimi për të cilin keni kohë që punoni mund të mos jetë ai që menduat në fillim. Kushtojini vëmendje të veçantë jetës suaj personale. Mund të debatoni me një prej familjarëve tuaj.

DEMI

Disa Demë do të duhet të bëjnë shumë përpjekje për të ruajtur pozicionin e mëparshëm. Mund të përballeni me një shtet të paparashikuar. Gjatë punës ka gjasa t'ju shfaqen disa probleme, për shkak të gabimit të një prej kolegëve tuaj.

BINJAKET

Kjo ditë për Binjakët do të kalojë shumë shpejt. Ka gjasa që të arrini rezultate produktive. Megjithatë, në mënyrë që gjërat të shkojnë ashtu sikurse keni planifikuar, duhet të ndiqni një plan hap pas hapi.

GAFORJA

Një problem me të cilin keni kohë që përballeni, mund të përshkallëzohet. Merrreni në konsideratë këtë parashikim dhe bëni gjithçka mundëni për të parandaluar ndonjë skandal.

LUANI

Kjo ditë mund të jetë një pikë kthesë për ju. Mund t'ju ndodhë një ngjarje që do t'ju ndryshojë jetën pozitivisht. Ka gjasa të mos e vini re menjëherë këtë ndryshim. Do të ndiheni konfuz, i stresuar për shkak të këtyre ndryshimeve, por ruani qetësinë pasi gjithçka është në favorin tuaj.

VIRGJERESHA

Virgjëreshat duhet të mendohen thellësisht. Ka gjasa të të mundojë një pyetje, të cilës druhen t'i dëgjosh përgjigjen. Është e rëndësishme të ruash integritetin, pak rëndësi ka se cila do të jetë përgjigja.

PESHORJA

Do të tregoheni shumë kritik ndaj vetes. Mos u shqetësoni nëse vini re disa njolla të çuditshme në fytyrë ose nëse keni shtuar kilogramë. Gjëra të tilla nuk duhet t'ju shpërqendrojnë nga planet tuaja. Për ata që merren me sport, do të kenë fat nëse do të futen në garë.

AKREPI

Akrepët duhet të tregohen të kujdesshëm pasi mund të përfshihen në telashe. Kjo këshillë është e vlefshme mbi të gjitha për ata që punojnë në autoritetin e një shefi të ashpër. Rekomandohet të tregoheni të zgjuar dhe me takt.

SHIGJETARI

Kjo e martë nuk do të jetë ashtu sikurse e prisni. Mund të haseni me shumë probleme në profesion dhe familje. Përpikuni të gjeni kohë për t'u relaksuar. Rekomandohet të flisni hapur me familjarët tuaj, pasi do të ndiheni shumë më mirë.

BRICJAPI

Bëni kujdes me shëndetin, pasi mund të keni shqetësime. Rrezikoni t'ju kthehet një sëmundje e cila keni vuajtur së fundmi. Kjo mund të ndikojë edhe në gjendjet tuaj emocionale. Nëse ju duhet të zgjidhni një çështje të rëndësishme sot, bëni mirë ta shmangni për një tjetër ditë.

UJORI

Ujorët do të ndihen nën presion. Është momenti i duhur për të luftuar për një pozicion më të mirë në punë. Shmangni meto-dra e padrejta për ta arritur këtë fitore. Në mbërnie përpikuni të krijoni një atmosferë të këndshme për partnerin/partneren tuaj.

PESHQIT

Peshqit sot mund të ndihen pak të trishtuar. Kjo ndodhë mund të vijë për shkak të mungesës së gjallërisë ose mungesës së mbështetjes nga ana e të afërmeve tuaj. Në mbërnie do t'ju duhet të ndërmerrni një vendim të rëndësishëm.

PRESIDENTI I FSHF-SË



Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, foli në tryezën e mbajtur për zgjidhjen e problemeve në futbollin shqiptar, ku kërkoi mbështetjen e qeverisë shqiptare, për ndryshimet në kodin ligjor, për rregullimin e futbollit. Futbollit lartëson emrin e një vendi dhe nëse menaxhohet mirë sjell të ardhura të konsiderueshme. Ka pasur paketë me ligje për nisim e një kryerje të njëkohshme

Duka: Vetëm vullneti politik e zgjidh krizën në futboll

të ndërhyrjeve, por që nuk u realizuan. Nëpërmjet ndryshimeve ligjore mund të zgjidhim disa probleme, siç janë formalizimi, taksat fiskale, lehtësira në ligjin e sponsorizimit. Modernizimi kalon nëpërmjet investimeve dhe duke pasur stadiume moderne, do të rrisë trengun dhe uroj të kemi më

shumë. Prania e tifozëve do të jetë më e madhe. Problemet në futboll nuk janë vetëm të sportit, por të shoqërisë. Shpresoj që ky takim të jetë takim shtyese dhe uroj më të mirën. Nëse ka vullnet politik, mund të zgjidhet gjithçka. Edhe unë nuk jam dakord që bashkitë të paguajnë rrogat për futbollistë dhe

klube të klube. Ju pak a shumë na i dhatë dritën jeshile. Besoj se me këto ndryshime do e kthejmë futbollin në një biznes fitimi. Mjafton vullneti. Në qoftë se kemi vullnet pozitiv, gjithçka mund të zgjidhet. Është e pamundur të ruajmë rendin me civilë. Ne kishim kamerat e të gjithë televizioneve, në "Selman Stërmasi", kur u dhunua fotografi, por nuk u dënua njeri. Kemi nevojë për policinë", -u shpreh Duka.

Një nga çështjet më të nxehta është siguria në stadione. Kryeministri akuzoi bashkitë për këtë



Jeton Selimi

Rama: Burg 3 vjet për tifozët që hyjnë në fushë!

Kreu i qeverisë kërkoi që klubet të mos punojnë me të zeze

Ndryshime të rëndësishme në ligjin për sportin. Në takimin e përbashkët mes krerëve më të lartë të Federatës Shqiptare të Futbollit, drejtuesve të klubeve shqiptare. Ministrin të Brendshëm Sandër Lleshaj dhe kryeministrin të Shqipërisë Edi Rama, ky i fundit theksoi se do të merrren masa të menjëhershme ndaj dhunës në futboll, pasi ligji për sportet do të ndryshojë dhe ata persona të paautorizuar që hynë në fushë dhe shkaktojnë dhunë do të ndëshkohen nga Kodi Penal me 3 vite burg. Numri 1 i shtetit në bashkëbisedimin në tryezën e përbashkët me presidentin e FSHF Armand Duka preku edhe shumë tema të tjera ndër-sa bëri publike edhe lehtësirat që pritet të ofrojë qeveria të gjithë ata persona që investojnë në futboll. "Dhuna në stadione nuk mund të tolerohet më. Policia e Shtetit dhe FSHF, mos ja lenë topin njerëtrrit, por të bash-



këpunojnë. Rikthimi i Policisë në stadione do të kërkonte amendimin e ligjit dhe një vendim të

posaçëm. Unë besoj se aq sa e rëndësishme është që të policia të përfshihet, aq e rëndësishme është që të

mos mbetemi thjeshtë se policia. Shqetësimi mbetet të impianetet sportive. Ka mjaft impiante që nuk i kanë parametrat minimale të sigurisë. Duhet bashkërisht të garantojmë monitorimin me kamera të të gjitha impianeteve. Teknologjia na i jep mundësi. Ne do të ndërhyjmë menjëherë në kodin penal. Kapërcimi i vijave të bardha dhe futja në fushë do të dënohet me 3 vjet burg. Ky do të jetë hapi i parë që ne do të bëjmë me parlamentin për të ndryshuar kodin penal. Klubet i deklarojnë rrogat sikur të ishin fasonë. Nuk do të ketë më kështu. Çdo klub duhet të deklarojë të ardhurat e futbollistëve. Asnjë klub

nuk zbaton ligjin. Do të ketë lehtësira për sa i përket timitit mbi fitimin. Do të vendosim një afat të caktuar kohor. Flasim për stadiume, por nuk kemi asnjë stadium të menaxhuar normalisht. FSHF është bërë si ambulancë që merr për sipër menaxhimin. Duhet që bashkitë së bashku me klubet të futen në një logjikë të re. Duhet të diskutojmë seriozisht për një fond për infrastrukturën sportive. U takon pronarëve të klubit që të bëjnë administrimin e stadiumit. Propozoj të kthejmë futbollin në një industri të mirëfilltë. Do të krijojmë komisione dhe grupe të veçanta. Secili grup me aspektet e caktuara. E fundit që kam është

nevoja për të parë mundësinë për zgjidhjen e arbitrazhit gjyqësor. Pse mos krijohet një strukturë këtu, por të shkoher deri në Lozanë. Për sa i përket dhunës, nuk do të tolerohet më askush. Për pikat e tjera, t'i kemi mbyllur si materiale, brenda 100 ditësh. Jemi të gatshëm të vazhdojmë të mbështesim fuqimisht, federatën dhe futbollin. Së shpejti do të kemi stadiumin e Kukësit, si dhe kemi në radhë stadiumet e tjera, si Durrësi, Vlora, Fieri, etj. Futboll pa lekë nuk bëhet. Me 100 tifozë depresiv, që vijnë të dielave, për të ushtruar talentin e tyre si mundësi dhe boksierë, nuk i duhen drejt jo më futbollit", -u shpreh kryeministri Rama.

PRESIDENTI I TIRANËS

Presidenti i Tiranës, Refik Halili, foli në mbledhjen e djeshme, duke shtruar disa probleme në lidhje me detyrimet e prapambetura të klubit bardheblu, të cilët e panalizojnë këtë të fundit, në marrjen e licencimit. Halili kërkoi një zgjidhje për këtë çështje, duke shpresuar më të mirën për futbollin shqiptar. "Më keq që kemi qenë nuk do bëhemi. Shpresoj që këto që u thanë të zgjidhen. Në 8 vite në momentin që klubi i Tiranës, shkoi drejt privatizimit, në momentin që ne e dorëzuam klubin, e dorëzuam me 48 mijë euro borxhe, teksa në një periudhë shumë të shkurtër, klubi shkoi në 2.4 miliardë borxhe. Bashkitë

Halili: Kemi borxhe të tmerrshme në tatime



duhet të jenë shumë të kujdesshme, për sa i përket marrëveshjeve dhe kontratat. Gara nuk fillon e pastër. Dikush e bën kontratën 200 mijë lek, dikush 2 milionë lek. Me ato që thate ju, futbollit do marrë rrugën e duhur. Kam një kërkesë, që klubet të jenë ndërmarrje shtetërore.

Gjyqet e viteve të mëparshme na penalizojnë dhe nuk marrim dot licencimin. Kemi dhe detyrime të tmerrshme në tatime në atë kohë dhe kjo na penalizon. Borxhet kapin 1.6 miliardë lekë. Është tmerr. Kërkoj marrëveshje nga tatimet për këtë pjesë", -u shpreh Halili.

Topi do nisë të rrotullohet


FSHF njofton fundin e bojkotit, sot luhet Kupa e Shqipërisë

KUPA E SHQIPERISE	
CEREKFINALET	
SOT	
Partizani-Luftëtari	14:00
Teuta Kukësi	17:00
NESER	
Tirana-Laçi	17:00

një vendin e tretë dhe të dytë në kampionat, ndërsa në "Niko Dovana" do të luajnë aktin e radhës të përballjeve mes tyre. Ndeshjet e Kupës do të mbyllën të mërkurën me përballjen e "Selman Stërmasit", ku Tirana do të presë Laçin me bardheblutë që synojnë

suksesin e parë pas tre vjetësh ndaj kurbinasve. Ndërkohë, me përjashtimin e Kamzës, Skënderbeu është bërë skuadra e parë gjysmëfinaliste. Ndërkohë, në orët e mbrëmjes, ka ardhur dhe njoftimi zyrtar i FSHF-së për mediat. "Federata Shqiptare e Futbollit dëshiron t'ju njoftoj se ndeshjet e Kupës së Shqipërisë, të planifikuara në kalendar për t'u zhvilluar nesër do të zhvillohen normalisht në oraret e para-caktuara". **Shënim:** Skënderbeu është kualifikuar në gjysmëfinale pas përjashtimit të Kamzës

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. O Toole aktor
5. Si vizuale.
11. Në fund të lutjes.
13. Janë popullsi e qytetit
14. Një pije freskuese.
17. Eshhtë enjije.
18. Teke prize.
20. Janë mallkime shkishëruese.
22. Një aftësi paranormale.
25. Janë fakultetet më me leverdi.
27. Gjigja e romakëve.
29. Thahen me bonifikim.
30. Zemeckis regjisor
33. Janë në temë
34. Inicialet e Harris aktor.
36. Eshhtë figurë gjeometrike.
37. Një markë makine qepëse.
41. Kush ka... ka zët.
42. Mbyllin komentin.
43. I bëhen të gjitha mikut.

45. Një version i dikurshëm i FIAT.
46. Fillojnë shkurt.
47. Një pikë në ligj.
48. Inicialet e Morricone-s.
49. Të fundit në manastir.
50. I ka kërcyer të xhindosurit.
51. Janë pjesë të dramës

VERTIKAL

1. Fillojnë panikun.
2. Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.
3. Në krye të tenorëve.
4. Mund të jetë gjaku dhe kuzhine.
5. Inicialet e Anka këngëtar.
6. Kush ka... ka nevojë për gjak
7. Ndiqet ajo e fundit
8. Duken të gjata në pritje.
9. Një fazë gjumi.
10. Shteti i francezëve
12. Një art i shtatë.
13. Eshhtë pellgu.
15. Shkroi Pa familje
16. Janë dokumente shtëpie.
18. Eshhtë filmi që mallëngjien.
19. Një kolegji anglez.
21. Janë baballarët.
23. Mund të jetë elektrike.
24. Eshhtë hidrofobi.
26. Ajo e forcës është për të çmendur.
27. Kremi pa ekstreme.
28. Si sezonale.
31. Mund të jenë unike
32. Mund të jenë periodike të tilla.
35. Eshhtë bishë që zgërdhiet.
38. Fillojnë nazet
39. Inicialet e Diamanti aktore.
40. Eshhtë mosha më e bukur.
44. Fillojnë temën.
46. Kufizojnë një send.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një film publicitar
5. Në krye të bashkisë
7. Me Romeo në makinë
10. Në fund majtas
11. Janë kompozime si Vejusha gazmore
15. Janë në masë.
16. Janë melodrama.
17. Fillojnë dobët.
18. Në hyrje të radios.
19. Një pjesë e lipotimisë.
21. Eshhtë gjendje të fikti.
24. Eshhtë vërtet i mërztishëm.
25. Maiden që këndojnë
26. Hurley aktore.
27. Pak torturuese.
28. Ekstreme në tunel.
29. Ndezur në aparaturë.
30. Ai i shenjtë është papa.
31. Merrte fuqi nga toka.
32. Pak enigmatike.

VERTIKAL


33. Ngriset në mbrëmje.
35. Kufij itinerari.
36. Ai i harresës ishte Leti.
39. Eshhtë porosia e fundit.
41. Janë bimë uji.
42. Opera e Mascagni-t.
44. Magritte piktor.
46. Eshhtë ndenjese zbukurimi.
48. Ndiqen me ilaçe.
50. Në krye të armiqve.
51. Një godinë në miniaturë
52. Eshhtë muzika... më e kollajtë.

VERTIKAL


1. Qe mbreti i parë i Izraelit.
2. Post scriptum
3. Një sferë... për model.
4. Eshhtë infeksion në bark
5. Një mund të jetë arme.
6. Në krye të atletëve.
7. Eshhtë grimcë me bërthamë.
8. Ishte sundimtar si Tutankamon
9. Masat pa Kufij
12. Një sport baskësh
13. Janë marrëdhënie.
14. Padija pa kufij.
16. Eshhtë në minorancë.
20. I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
22. Kështu janë lojtarë te formaconit
23. Janë të holla dhe therëse.
26. Makinë ruse.
32. Eshhtë dita e dytë
34. Bisha aktore.
37. Në mes të rrugës.
38. Një trup pa kënde.
40. Satie kompozitor.
43. I ka të ndryshme një sakat.
45. King Cole i muzikës.
46. Inicialet e Penn aktor.
47. Në mes të dhomës.
49. Të fundit në spital.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

F	A	U	T	O	P	O	R	T	R	E	T
A	S	T	R	I	D	K	O	R	E	K	
R	H	I	C	B	E	P	M	A			
A	K	M	A	R	A	T	O	N	A	A	P
D	O	N	A	T	O	R	E	T	R	I	T
P	I	R	A	T	I	E	I	E	T	C	
K	I	N	E	M	A	T	E	T	E	R	R
R	I	T	A	A	M	E	T	R	A	T	
T	V	E	N	U	S	B	E	T	A	L	E
J	O	E	E	R	P	E	T	A	L	E	T
I	D	A	I	T	K	A	E	M	I	L	E
M	A	L	A	M	I	N	A	K	E	T	
P	I	E	R	V	M	A	R	A	T	B	
E	R	A	M	E	Z	O	N	E	M	A	
R	E	M	I	R	E	L	O	M	R		
I	N	A	K	O	L	O	N	I	T	E	
P	E	R	S	E	R	I	T	E	S	T	
A	T	E	L	E	G	O	N	I	O	P	
A	T	R	E	N	T	V	A	N	E	N	
E	M	R	A	T	Z	K	O	M	E	T	
T	I	T	M	A	N	E	T	M	A	T	
I	T	A	O	R	N	A	T	E	I	L	
K	D	R	O	M	A	N	R	A	K		
E	U	R	E	K	A	A	T	O	M	T	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

		7		8		9		
4								
				3		7		
	6		3					2
		9		5		1		7
3							5	
					9			4
8	4		6		2	3		
	9							

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	7	3	1	4	8	9	6	2
4	9	1	7	2	6	8	5	3
8	6	2	9	3	5	4	7	1
6	1	7	2	9	3	5	8	4
9	2	5	4	8	1	6	3	7
3	8	4	6	5	7	2	1	9
2	3	6	5	7	4	1	9	8
7	5	9	8	1	2	3	4	6
1	4	8	3	6	9	7	2	5

Argëtim filozofik

- Humbim veten tonë për njerëz që nuk himen asgjë për ne.
- Kurrë mos u kujto prezencën tënde...Askush nuk të harron gabimisht.
- Kur dashuron me të vërtetë, mund të rriri orë të tëra në heshtje dhe të ndjeheni sikur i kenit thënë të gjitha.
- E kaluara është mësuës i së tashmes dhe udhëzues i së ardhmes.
- Jeta në vetvete ka vështirësi. Eshhtë përgjegjësia jonë të krijojmë gëzim.
- Gabimi më i madh i një burri, është t'i japim mundësinë dikuj tjetër të bëjë gruan e tij të buzëqeshi.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

15	D	7	2	3	1	4	2	17	6	2	4	
6	O	2	3	10	11	17	4	9	3	2		
17	B	7	8	6	9	6	13	4	6	17	7	
7	I	11	7	2	6	1	4	2	2	4	8	
8	S	6	12	4	13	2	4	2	4	9	4	
18	3	1	4	12	4	1	4	1	3	3		
2	3	12	2	3	12	3	1	16	1	1	3	
16	3			4	15		16	2	7			
15		2	4	8	16	2	12	7	2	4	2	
4	18		1	1	7		8	7	9	6	13	7
12	7	1	7	3	12		8	1	4	1	4	2
7	2	3		10	7	3		3	2	7		6

T	R	I	M	S	M	M	A	S	A	T	
A	R	B	E	E	M	L	I	M	A		
K	D	E	L	E	G	A	T	E	T	L	
M	I	T	O	M	A	N	E	T	D	E	
K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	T	
O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	F	
M	N	I	E	N	O	G	F	A			
P	S	N	N	I	M	A	L	L	I		
A	M	I	A	N	T	K	O	S	E		
N	O	T	E	K	I	P	O	R	E		
I	T	N	E	T	I	L	E	N	I	E	
A	L	I	B	E	S	I	R	T	A	R	I

Thënie të mençura

- Kuptimi i vërtetë i jetës është të mbijellësh një pemë, nën hijen e së cilës nuk prisni për t'u ulur.
- Përpara ngrëjmë një re pluhuri dhe pastaj ankohe mi se nuk mund të shohim.
- Jeta është një komedi për ata që mendojnë dhe një tragjedi për ata që ndjejnë.
- Ajo që tashmë dimë, është ajo që na pengon të mësojmë.
- Kushdo që përpiqet të duket diçka, siguron tjetrin se është i parëndësishëm.

